

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktor: Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7324 E hënë 16 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Kur ishte Berisha kryeministër, tentoi të joshte Berlusconi, këtë ashik gjysmë demodë e gjysmë modern, falë operacioneve plastike dhe lirshmërisë...

Vijon në faqen 20

Nga KIÇO BLUSHI

Si mund të mburresh me sindikatat që nuk funksionojnë?



Opinion i Ditës

Se sa i vështirë është integrimi në SBE, e tregon ndër të tjera fenomeni, që edhe pas anëtarësimit të vendit të tyre në BE, disa udhëheqës e kanë të vështirë ta...

Vijon në faqen 21

Nga SHABAN MURATI

Presidenti "rus" i Republikës Çeke



I kërkuari Laert Haxhiu I kërkuari Orges Bilbili

Vrasja në Lushnjë, dëshmitarët: Shoferi mbante në dorë radiomarrëse

Ja tri rrugët nga ku mund të jenë larguar atentatorët e Latifit dhe Hoxhës

Pas masakrës së Lushnjës, ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj paralajmëroi gjatë një vizite-blec se do të ketë largime dhe ndjekje penale për efektivet që dyshohet se kanë ndihmuar autorët të largohen nga vendngjarja. Dëshmitarët kishin parë që njëri nga atentatorët, i cili qëndronte në timon, kishte radio...

INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQERORE, TABELAT ME PAGAT REFERUESE TE MIRATUARA

PENSIONET, SI TE LLOGARISNI MASEN PARA DHE PAS VITIT '94

Disa shembuj konkretë për të mësuar se sa do t'ju dalë pensioni i pleqërisë duke iu referuar ndryshimeve të bëra në ligjin për sigurimet



Kodi	Emri	Pensionimi / puna	Paga referuese mujore
Agjencitë e Krahëve të Mbrojtjes			
01	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
02	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
03	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
04	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
05	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
06	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
07	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
08	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
09	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
10	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
11	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
12	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
13	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
14	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
15	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
16	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
17	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
18	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
19	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
20	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
21	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
22	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
23	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
24	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
25	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
26	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
27	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
28	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
29	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
30	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
31	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
32	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
33	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
34	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
35	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
36	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
37	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
38	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
39	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
40	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
41	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
42	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
43	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
44	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
45	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
46	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
47	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
48	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
49	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
50	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
51	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
52	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
53	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
54	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
55	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
56	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
57	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
58	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
59	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
60	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
61	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
62	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
63	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
64	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
65	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
66	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
67	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
68	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
69	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
70	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
71	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
72	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
73	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
74	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
75	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
76	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
77	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
78	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
79	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
80	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
81	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
82	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
83	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
84	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
85	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
86	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
87	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
88	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
89	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
90	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
91	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
92	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
93	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
94	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
95	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
96	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
97	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
98	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
99	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500
100	Agjencia e Krahëve të Mbrojtjes		1.500

(Në foto) Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Faksimile e pagave referuese para datën 01.01.1994

REAGON ISH-DEPUTETJA
'Minoritetet',
kërcënon presidenti grek: Shqipëria po dëmton anëtarësimin

DRAMA NE POGRADEC
Përdhunoj e la shtatzënë të miturën, arrestohet 55-vjeçari. Xh.B.: Më vinte turp

VRASJA E POLICIT
Vrasja e Çollakut, eksperti: Të dhënat e GPS mund të jenë fshirë

LISTA E PERDITUSUAR
Pronarët në Shkodër, kush është kompensuar e statusi i pronës

KANCERI, DESHMITE

Ylli Merja

Mënurat në ti

Mjeku popullor

Ylli Merja: Mënurat për të kuruar artritën brenda një jave

Suplement

Dokumentet e libri "Shkrimtarët dhe artistët në diktatin komunist..."

Kaplan Resuli, Enverit: Më merrni në mbrojtjen tuaj

Zbulohet letra e shkrimtarit dërguar nga qelia diktatorit në 1971-shin

Nga DASHNOR KALOÇI

Nga fundi i vitit 1948, kur Enver Hoxha prishi dhe ndërpreu marrëdhëniet tejet miqësore me Jugosllavinë e Marshallit Josif Broz Tito, me të cilin ishte lidhur ngushtë që nga viti 1941, (kur ata e ndihmuar për krijimin e



Partisë Komuniste dhe zgjedhjen e tij në krye të saj) dhe, gjithashtu, largimin e Beogradit nga Blloku i Lindjes që kontrollohej nga Moskë, në drejtim të Shqipërisë fil-luan të vinin mjaft shtetas jugosllavë që e konsideronin veten besnikë të Stalinit...

**OPOZITA
TAKIMET**

Kreu demokrat takon pronarë të biznesit të vogël në Paskuqan: Bashkohuni

Lulzim Basha: Rritja e TVSH-së çmenduri, do falimentojë biznesin

"Rama nuk ndjen detyrim për qytetarët, por për kriminelët"

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, takoi dje përfaqësues të biznesit të vogël, lidhur me projektin e qeverisë Rama për përfshirjen e tyre në skemën e pagesës së TVSH. Tregtarët e vegjël, me biznes kryesisht familjar në zonën e Paskuqanit, thanë se futja e tyre në skemën e TVSH do të sjellë kosto shtesë për ta, rritje çmimesh, dhe pamundësi për të mbajtur aktivitetin, pasi edhe me çmimet aktuale ata mezi ia dalin të mbyllin muajin. Basha theksoi se ai dhe Partia Demokratike do të luftojnë që kjo çmenduri të mos ndodhë dhe kërkoj bashkimin e biznesit të vogël në këtë betejë. "Vijnë e na gjobisin. Ne nuk e çojmë mallin jashtë shtetit. Kontrabandën nuk e bëjmë ne, biznesi i vogël. Na vendosin 500 mijë lekë gjobë. E për çfarë?! Për një kupon. Mund ta bësh gabim kuponin nga 200, në 2 mijë lekë, por prapë të vënë gjobë. Kjo është për të mbyllur dyqanin. Më kanë borxh prej 2 vitesh, s'kanë lekë të më sjellin", tha Xhevairi, një pronar i një dyqani materialësh ndërtimi. Festimi ka një bar buzë rruge, me të cilin jeton. Ai thotë se rritja e TVSH-së do e bëjë të mbyllë lokalin. "Nëse do rritet TVSH-ja, do rris çmimet. Nga 500 lekë që e kam kafën do e çoj 700. Prapë populli do e hajë. Po e rritta çmimin s'ka për të ardhur njeri në lokal. Unë me thënë të drejtën kam qenë i majtë. Nuk jam i kënaqur fare. Nuk ecet më. 27 vite e tani po shkojmë poshtë. Nuk ecet më me mashtime", tha Festimi. "Ne kemi dalë sot t'u dëgjojmë. Ne këtë qëndrim kemi që rritja e TVSH-së do shkatërrojë biznesin e do rrisë çmimet. Për këtë arsye jemi kundërvënë, nuk është se po bëjmë politikë", -iu përgjigj Basha. Kreu i PD-së shpjegoi ndërkaq projektin e tij. "Ne qeverisë i themi ta bëjë biznesin e vogël me 12 milionë lekë të reja në vit xhiro, ose 120 milionë lekë të vjetra, 120 milionë e poshtë quhet bi-

znesi i vogël dhe pa TVSH. Ne jemi kundër rritjes së TVSH-së pikërisht se do rrisë çmimet e do falimentojë biznesin", -tha Basha. Ndërkohë më

pas, kreu i PD-së, në një status në rrjetin social, "Facebook", shkroi: "Edi Rama nuk e ka ndërmend t'u vijë në ndihmë 30% të familjeve,

që nuk blejnë dot ushqime, 39% të familjarëve, që nuk paguajnë dot faturat e dritave dhe ujit, 43% të familjeve, që nuk sigurojnë dot ngrohje për fëmijët". "Përkundrazi ai duke futur biznesin e vogël në skemën e TVSH, do të rrisë çmimet dhe vështirësojë edhe më shumë jetën për shqiptarët. Sepse Edi Rama nuk ndjen detyrim për qytetarët, vetëm për kriminelët që e mbajtën në pushtet. Prandaj çdo ditë të qeverisjes së tij ia kushton krimin dhe krimineleve, herë duke mbyllur sytë para hashashizimit të vendit, herë duke ndihmuar kriminelët të arratisen e herë duke fshehur urdhërrarrestet ndërkombëtare për ta", - u shpreh kryedemokrati.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha në Paskuqan



Gjatë një seance parlamentare

Denoncimi



KOKËDHIMA

ZGJIDHJA, e drejtuar nga Koço Kokëdhima, denoncoi planin e qeverisë dhe të bashkisë për të prishur dy banesa të vjetra në Shkodër, për t'i hapur rrugë një pallati shumëkatës. Në një reagim në "Facebook", ZGJIDHJA tregoi foton aktuale të banesave të vjetra historike.

Punonjësi i policisë i shkruan kryedemokratit

Kreu i PD-së: "I forti" i Fierit mori peng qytetarin dhe policia nuk ndërhyri

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha publikoi dje një mesazh të një qytetari nga Fieri, sipas të cilit, shtetasi Renato Çami ka marrë peng për tre ditë një qytetar dhe se policia nuk ka ndërhyrë, pavarësisht denoncimit. Sipas mesazhit të publikuar nga Basha, ngjarja ka ndodhur në lagjen "1 Maji" të qytetit dhe se qytetari është detyruar të tërheqë denoncimin nga reanimacioni. "Ky është shteti mafioz i Edi Ramës dhe Gramoz Ruçit me kompani: "Përsëritet zoti Basha, unë që po ju shkruaj jam një punonjës policie në rrethin e Fierit dhe dua t'ju tregoj për një ngjarje që ka ndodhur në qytetin e Fierit ku para rreth dy javësh është marrë peng nga Renato Çami një qytetar për tre ditë dhe policia nuk ndërhyri dhe nuk shkoi fare të banesa e këllë të fundit. Pasi u lirua pas tre ditësh qytetari i marrë peng shkoi në spital në reanimacion në gjendje të rëndë dhe kur shkoi policia



Faksimile e statusit në "FB" të kreut të PD-së

si kishte deklaruar se ishte marrë peng nga Renato Çami në lagjen "1 Maji" në banesën e tij ku nuk guxon të futet njeri, aty erdhën prapë ushtarët e Renatos dhe e kishin goditur dhe ky person kishte ndryshuar dëshminë e tij", - thuhet në dëshmi.



Presidenti Ilir Meta

Kreu i shtetit promovon bukuritë e veriut

Meta në Theth: Nuk jam në Tirol të Austrisë, vizitojeni

Presidenti i Republikës, Ilir Meta promovoi dje bukuritë e Alpeve shqiptare, Luginën e Valbonës dhe Thethin. Gjatë kësaj vizite në veri të vendit, Meta ka është ndalur edhe te "Syri i Kaltër", një tjetër bukurri natyrore që ofron parku kombëtar i Thethit. Presidenti është shprehur i mrekulluar nga bukuritë natyrore që ofrojnë Alpet shqiptare, teksa i ka bërë thirrje të gjithë shqiptarëve që të mos e humbasin mundësinë që të vizitojnë këto vende të rralla turistike. "Mos mendoni të dashur miq se jam në Tirol të Austrisë apo diku tjetër, në Alpet e Evropës. Jam te 'Syri i Kaltër' në Theth të Shqipërisë, në Alpet më të bukura në botë. Mos e humbini mundësinë për të vizituar 'Syrin e Kaltër' këtu në Theth në zemrën e Alpeve tonë", - shprehet Presidenti Meta, në një video të regjistruar në Veri të vendit.



Kryeministri: Rruga e BE, e hapur për negociatat në qershor të 2018

Droga, Rama: Luftë kundër rrjeteve kriminale, bashkë me SHBA e BE

"Opozita të bashkëpunojë për interesat e vendit"

Drarina Tanushi

Kryeministri Edi Rama rinisi dje, tra ditën e të dielave të tij, me rubrikën "Komunikimi javor", ku deklaroi prerë se grupet kriminale në vend do të vihen para drejtësisë. "Do vijojmë luftën duke çuar para betejën kundër rrjeteve që kanë përfitur nga sipërmarrja kriminale e kultivimit të kanabisit dhe jo vetëm prej saj, duke identifikuar e sekuestruar asetet kriminale të përfitura nga individët e organizuar në këto rrjete, duke ndaluar dhe çuar para drejtësisë të fortët, të mësuar prej shumë vitesh të livadhshin falë korrupsionit të policisë, prokurorëve dhe gjykatësve", - tha dje, kryeministri. Në fakt, komunikimin e tij, Rama e nisi me lajmin që ai e quajti inkurajues për javën që shko, takimin me drejtorin e BE për Zgjerimin. "Është e qartë se Shqipëria po vijon të bëjë progres në rrugën e duhur. Objektivi ynë për çeljen e negociatave për anëtarësim në BE në mesin e vitit tjetër është i arritshëm, duke vijuar punën për secilin fushë. Nuk ka asnjë ekuivok në këndvështrimin e partnerëve tanë strategjikë lidhur me dy histori suksesi të këtij viti, duke thelluar reformat dhe nxitit zhvillime të reja në planin e shtetbërjes dhe në planin ekonomik", - u shpreh kryeministri. Sipas tij, "zgjedhjet e 25 qershorit ishin një histori suksesi për vendin. Shqipëria ia doli pas një situatë të rënduar tej mase, nga bojkoti i parlamentit, çadra e bulevardit, refuzimi i opozitës për të pranuar zgjedhjet". Ai shtoi se "këtyj qëllimi i shërbens Komisioni i Posaçëm Parlamentar që u votua në Kuvend, pas dy bllokimeve të pajustifikueshme të foltores. Propaganda e shfrenuar kundër zgjedhjeve, e atyre që nuk dolën fitues në ballafaqimin e 25 qershorit është, shfaqje e dobësisë së brendshme. Nëse vazhdojnë kështu, jo vetëm rrezikojnë një humbje tjetër; por edhe do të dobësohen si faktorë politikë. Por kjo është çështja e tyre dhe jo e jona, dhe as e njerëzve që duan shtet, punë, mirëqenie dhe jo llafe e sherre".

DROGA
Ai vlerësoi si histori suksesi edhe pastrimin e Lazaratit nga kanabisi. "Kjo bete-



Kryeministri Edi Rama

MBLEDHJA NË DIBËR
Pas Vlorës, kryeministri Rama njoftoi se radhën tashmë e ka Dibra. Ndaj muajin tjetër, ministrat dhe ai vetë do të zhvillojnë mbledhjen e kabinetit në këtë qark, për të shpalosur edhe projektet për këtë zonë, ashtu siç u bë edhe me Vlorën dhe siç do të ndodhë edhe me qarqe të tjera në vijim.

Kreu i qeverisë inspekton punimet në qendrën e Kaninës

Orikumi me nënstacion të ri, Rama: Zgjidh dramën e gjithë bregdetit Jon

Kryeministri Edi Rama inspektoi gjatë fundjavës qendrën e Kaninës, e cila me një vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave kthehet në zonë të mbrojtur të trashëgimisë kulturore. Ristrukturimi i sheshit historik, duke ruajtur traditën e zonës, si dhe rikonstrukcioni i Pallatit të Kulturës, aktualisht jashtë funksionit, por që pritet të kthehet në një qendër moderne kulturore, do të shtojë numrin e vizitorëve e turistëve që vizitojnë fshatin me tradita kulturore dhe bukuri natyrore. I shoqëruar edhe nga deputeti Fate Velaj, ministri i Infrastrukturs dhe Energjisë Damian Gjiku dhe zëvendësministri Artan Shkreli, kryeministri sugjeroi kthimin në jetë të ish-Qen-




Kryeministri Edi Rama, dje në Kaninë

drës së Kulturës. Po ashtu, Rama inspektoi edhe nënstacionin elektrik të Orikutit, i cili pritet të sigurojë furnizim të pandërprerë me energji elektrike të bregdetit të Vlorës. "Gjithë drama e rëndë e shumë viteve të bregdetit Jon, - u shpreh kryeministri Rama gjatë inspektimit të punimeve, - me këtë zgjedhje përfundimisht, se ky është

segmenti i fundit i boshllëkut që ishte krijuar që nga elektrifikimi dhe që ka torturuar dynjanë këtu, plus që e bënte sezonin turistik një torturë më vete". Gjatë kësaj vizite, Rama vizitoi edhe Parkun Arkeologjik të Orikutit, një destinacion turistik i preferuar për natyrën e tij detare dhe malore.


gjedhje, dhe të kriminalizojë qeverinë përmes shpifjeve, për të shmangur vëmendjen prej dobësisë së saj. Kjo është një përpjekje e dëshpëruar dhe e padenjë e një opozite, që në mungesë të vizionit, programit, skuadrës, lidhshimit, rreket si e marrë ta shfrytëzojë krimin për të ndjellë pasiguri, por qeveria as e zgjedh opozitën dhe as zgjedh dot për llogari të saj se çfarë qëndrimesh duhet të mbajë opozita në të mirë të vendit", -

tha Rama më tej. "Ne jemi zgjedhur nga shqiptarët për të mirëqeverisur dhe kemi zgjedhur rrugën e dialogut dhe të bashkëpunimit me opozitën. Bashkëpunim vetëm me vullnetin e një pale nuk mund të ketë, por ne nuk do ta humbasim durimin dhe do vijojmë t'i bëjmë thirrje opozitës të bashkëpunojë për interesat e mëdha të vendit dhe të krijojmë kushtet për këtë dialog", - theksoi kryeministri.



Xhaçka me banorë të Bestrovës: Zhvillimin do ta sjellim edhe në fshat

Ministria e Mbrojtjes, Ojta Xhaçka u takua në fundjavë me banorët të fshatit Bestrovë e Vogël, pak kilometra larg Vlorës. Ministria siguroi banorët se vëmendja ndaj fshatit dhe zonave rurale këtë 4-vjeçar do të jetë maksimale. "Nuk është e lehtë të administrosh pak gjë, e megjithatë, në katër vite ne kemi qenë ekonomiqarë të mirë. Dëshira është jashtëzakonisht e madhe për të bërë shumë më tepër nga çfarë kemi mundësi të bëjmë, por të paktën jemi në rrugë të mbarë. Kemi investuar te gjërat kryesore, e tani do të fillojmë të shtrihemi në ato, le të themi dytësore, pra nga qyteti do të vijmë në fshat. Zhvillimin urban do ta sjellim edhe në fshat, do të bëjmë çmos që problemet e gjithsecilit të vlerësohen. Dua që të kemi besim, që ne po bëjmë maksimumin për të qenë sa më besnikë ndaj atyre gjërave që kemi premtuar dhe që kemi thënë", - tha ajo mes të tjerash.



Balla inspekton punimet për banesat e 16 familjeve egjiptiane në Librazhd

Kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla, i shoqëruar nga kryetari i Bashkisë së Librazhdit, Kastriot Gurra, inspekton punimet për rikonstrukcionin e banesave të komunitetit egjiptian, projekt i Bashkisë së Librazhdit, i financuar nga Ministria e Zhvillimit Urban. Nga faza e parë e këtij projekti përfituan 16 familje, banesat e të cilave ishin në gjendje më të rënduar, disa prej tyre tërësisht të pabanueshme. Deputeti Balla tha se projektin do të vazhdojë më tej. "Ndoshta është një shembull shumë pozitiv dhe shumë domethënës që një ditë pas miratimit në Kuvend të ligjit për pakicat, unë jam këtu për të parë nga afër sesi po implementohet faza e parë e një projekti që do të zgjasë edhe në muajt në vijim, edhe vitin e ardhshëm, për të rikonstruktuar shtëpitë e familjeve të këtij komuniteti", - tha Balla.

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ
Permbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin për shijën e pasurisë se pajualjshme "Aparamenti", me Nr. Pasurisë 5/330-1-S, Zona Kaldasale 8/13, Nr.14, Fq.69, me sipërfaqe 52.02 m², të ndodhur në P.Slorit 17, Pali 9781, Shk.1, Apër, Durres, për shlyerjen e detyrimit në favor të kreditit Prof.Credit Bank Sh.p., për shumën 1747880.58 (një milion e nentqind e dyzet e shtatë mijë e tetëqind e tetëqindë pika pesëdhjetë e tetë) Loke dhe 33.6 (tridhjetë e tre pika gjashtë)Euro. Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi është në shumën 22'400 (njëzetë e dy mijë e katërqind) Euro.
Ankandi zhvillohet në datë 25.10.2017, ora 16:00 në zyrën e përmbarsit gjyqësor privat Ermir Godaj, Rruga Abdi Toptani, Oendra Torre Drin, K1.2, Nr.33, Tirane, dhe për informacion mund të kontaktoni në Nr.0682909471, 0684054605, email ermirgodaj@zyraparbarmit.com.

Ligji për pakicat, Athina: Përrjetëson arbitraritetin e regjimit të Hoxhës

"Minoritetet", Pavlopulos: Shqipëria po dëmton vetë anëtarësimin në BE

"Prishtina e Tirana, sjellje të aventurizmit ndërkombëtar"

Darina Tanushi

Qeveria greke "kërcënoi" dje, qeverinë shqiptare sërish me hapjen e negociatave. Pas votimit në parlament të ligjit për pakicat, Ministria e Jashtme greke reagoi përmes zëdhënësit të saj, Aleksandros Gjenimatas. "Në vend që të sigurojë të drejtat e pakicave në vend, bazuar në standardet europiane, projektligji që votoi parlamenti shqiptar mbi mbrojtjen e minoriteteve përrjetëson abuzimet e regjimit të Enver Hoxhës. Ky është një hap përpara për pakicat reale dhe joekzistuese dhe një hap prapa për minoritetin kryesor dhe ekzistues të Shqipërisë", thuhet në deklaratën e Ministrisë së Jashtme greke.

Ndërsa nga Korfuzi, në përrurimin e muzeut të politikantit të njohur grek të shekullit XVIII, Ioannis Kapodistrias, presidenti grek Prokopis Pavlopulos ka lëshuar një tjetër deklaratë të fortë ndaj Shqipërisë, madje kësaj here ka përfshirë edhe Kosovën. Pavlopulos ka akuzuar Tiranën dhe Prishtinën se po sillen si "aventurierë ndërkombëtarë", dhe ka shtuar se "Shqipëria dëmton vetë procesin e anëtarësimit në BE". Pavlopulos i bëri këto deklarata të dielën paradite në Korfuz, ku u inaugurua muzeu i Joannis Kapodistrias, guvernatori i parë i Greqisë pas çlirimit nga zgjedha osmane. Ai tha se "Kapodistrias ka dy karakteristika: vizionin dhe respektimin e plotë të së drejtës ndërkombëtare. Kjo na frymëzon ne grekët, por duhet të frymëzojë edhe ata që aspirojnë të futen në BE". "Dhe këtë e them kryesisht për Shqipërinë fqinje, vendin me të cilin duam gjithmonë të kemi marrëdhënie të mira, dhe që e mbështesim në procesin e anëtarësimit", - tha presidenti grek. Duke marrë shkas



Presidenti grek Prokopis Pavlopulos dhe ministri i Jashtëm Nikos Kotzias



ndoshta nga fakti i emërimit të zëvendësministrave nga Kosova në qeverinë "Rama 2", Pavlopulos vazhdoi: "Mirëpo, sjellje të aventurizmit ndërkombëtar si ato që po shohim tani së fundi ndërmjet Tiranës dhe Prishtinës janë sjellje të një shkeljeje brutale të të drejtave të njeriut, dhe kjo po ndodh me minoritetet apo, për shembull si me të drejtën e pronës. Faktikisht, për fat të keq, Shqipëria dëmton vetë procesin e anëtarësimit, dhe kjo nuk është përgjegjësia jonë". "Gjithsesi, ne nuk do të rrimë duarkryq ndaj sjelljeve të tilla. E kemi obligim edhe ndaj Greqisë, por edhe kundrejt Evropës", - përfundoi Presidenti i Republikës greke, Prokopis Pavlopulos.

LIGJI

Javën që sapo u mbyll par-

lamenti shqiptar miratoi mes debatesh ligjin për minoritetet. Ky ligj pati kundërshti nga ana e kreut të PBDNJ-së dhe atij të OMONIA-s, të cilët e kanë konsideruar hap prapa për minoritetin grek këtë ligj. "Do ta quaja fatale, nëse ky ligj do të shkonte nesër ose pasnesër për votim në parlament. Është një ligj që nuk i shton asgjë konventës-kuadër; por i heq, duke ia kaluar kompetencat Këshillit të Ministrave. Heq edhe shumë të drejta që ne i kishim nga konventa-kuadër e Këshillit të Europës", - tha Leonidha Papa, kryetar i shoqatës OMONIA, gjatë konsultimit të ligjit në prani edhe të ministrit të Jashtëm Ditmir Bushati. Ministri i justifikoi kalimin e ligjit me faktin se nuk do të ketë më të privilegjuar mes pakicave.

NIKOS KOTZIAS

Vetëm pak ditë më parë, ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias tha se minoriteti duhet të njihet në gjithë shtrirjen e territorit dhe kudo ku minoritetët grekë ndodhen në Shqipëri. Sipas tij, "bie ndesh me të drejtën europiane 'reforma' e Hoxhës që minoritet konsiderohesh vetëm nëse ndodhesh në dy zonat e njohura si të tilla, ndërsa po të largohesh nga fshati yt e të shkosh në Tiranë, nuk je më minoritet".

PROKOPIS PAVLOPULOS

"Me sjellje të një aventurizmi ndërkombëtar, si ato që po shohim së fundi të shtohen mes Tiranës dhe Prishtinës, të cilat janë sjellje të shkeljes brutale të të drejtave të njeriut, si dhe ato që po ndodhin me minoritetet ose me të drejtën e tyre të pronës, Shqipëria, për fat të keq, po dëmton procesin e anëtarësimit, dhe kjo është përgjegjësia e saj", - tha presidenti grek.

Ish-deputetja e PDIU: Po rritet aktiviteti antishqiptar në rajon

Reagimet e Greqisë, Mesila Doda: Jemi në një moment të rrezikshëm

Ish-deputetja e PDIU-së, Mesila Doda reagoi dje ashpër ndaj qëndrimeve të autoriteteve greke ndaj Shqipërisë. Në një status të saj në rrjetin social "Facebook", Doda shkroi dje: "Skeni parë gjë akoma... Për këtë kam këmbëngulur se PDIU-ja, edhe sikur të mos ekzistonte do duhej të krijohet 10, 100, 1000 herë". "Tash që politikanët e Tiranës i lanë duart e kanë heshtur si fija e barit për çështjen çame, askush nuk guxon t'u përvishet këtyre pasardhësve të Zervës. I kërkojnë Shqipërisë respektimin e të drejtave të njeriut dhe vetë fletë mbi fëmijët e pleqtë e vrrarë, në shpëtitë e grabitura, në pronat e dhunuara, mbi varret e paemër", u shpreh dje, ish-deputetja. "Jemi në një moment të rrezikshëm të historisë sonë. Të marrët, afruan PDIU-në si flinë e paqimit... por grekët po i kërkojnë kusurin.



Ish-deputetja e PDIU-së, Mesila Doda

por për Atdhe", e mbylli ish-deputetja reagimin e saj, pas qëndrimeve të presidentit grek dhe ministrit të Jashtëm Kotzias. Ndërkohë, për çështjen çame ka propozuar një rezolutë deputeti

shqiptar në Parlamentin Evropian, Ahmet Gjana. Por presioni grek duket se vazhdon të jetë i fortë, deri në atë pikë sa pala tjetër ka menduar të bëjë fushatë anti-çame.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje e suportit një vjeçar të produkteve Checkpoint"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 3,800,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë parapikësimin pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje e suportit një vjeçar të produkteve Checkpoint"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **8 Nëntor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON"
me PËRMBARUESE GJYQËSORE SUELA METHOKHA

Dt 13.10.2017 ora 16:00
Përfundon Ankandi i Parë për pasuritë:

- Pasuria "Apratament" me sip. 27 m2, Nr. pasurie 7/ 83+1-3, Z. K 8552, Vol. 3, Fq. 166 me adresë L. Nr. 5 Kavajë
- Me çmim 7 840 EURO
- Pasuria "Apratament" me sip. 40 m2, Nr. pasurie 7/ 83+1-3/1, Z. K 8552, Vol. 3, Fq. 167 me adresë L. Nr. 5 Kavajë
- Me çmim 11 600 EURO
- Pasuria "Apratament" me sip. 66 m2, Nr. pasurie 7/ 83+1-4, Z. K 8552, Vol. 3, Fq. 168 me adresë L. Nr. 5 Kavajë
- Me çmim 18 960 EURO

Ankandi Zhvillohet në zyrën e STUDIO PËRMBARIMORE GJYQËSORE "KREON", me adr: L.11, Blv.kryesor (ish kinma iliria) ,Kati-2, Durrës, Kontakt Çel 0682096575

Ministri Xhafaj paralajmëroi ndjekje penale, ja 3 rrugët ku mund të jenë larguar autorët

3

Pas masakrës së Lushnjës, ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj paralajmëroi gjatë një vizite-bleic se do të ketë largime dhe ndjekje penale për efektivet që dyshohet se kanë ndihmuar autorët të largohen nga vendngjarja. Dëshmitarët kishin parë që njëri nga atentatorët, i cili qëndronte në timon, kishte radio policie në dorë. Duket se vizita-bleic e ministrit të Brendshëm Fatmir Xhafaj dhe numrit 1 të Policisë së Shtetit, Haki Çako, e zhvilluar mbrëmjen e së shtunës në komisariatit e policisë së Lushnjës, ka pasur një motiv të fortë, raportoi "ABC News". Ekzekutimi i tipit mafioz në qendër të qytetit dhe shumë pranë komisariatit të policisë Lushnjë të Zamir Latifit dhe Jurger Hoxhës, ka krijuar dyshime se tre atentatorët mund të jenë ndihmuar ose favorizuar nga uniformat blu, pasi këta të fundit nuk reagojnë në kohë. Për këto dyshime, ministri Xhafaj ka paralajmëruar se do të ketë largime dhe ndjekje penale për efektivet e policisë që janë të përfshirë në afëra të pista, duke paralajmëruar largimin e tyre nga puna. Këto dyshime përforcohen edhe më shumë, pasi dëshmitarët kanë deklaruar se në vendngjarje kanë shquar se atentatorët ishin Laert Haxhiu dhe Orges

Masakra në Lushnjë, atentatorët mund të jenë ndihmuar nga policia

Dëshmitarët: Shoferi mbante në dorë radiomarrëse



I kërkuari Laert Haxhiu



I kërkuari Orges Bilbili

Bilbili, ndërsa drejtuesi i automjetit tip "Mercedes-Benz" që largoi nga vendi i krimit vrasësit mbante në dorë një radiomarrëse, si ato të policisë. Ky person vijon ende të mos jetë zbuluar nga uniformat blu, por nuk përjashtohet

mundësia e përfshirjes edhe të shumë njerëzve të tjerë në atë ngjarje kriminale që tronditi gjithë qytetin. Ndërkohë, pak pas masakrës së Lushnjës, e ndodhur më 11 tetor, autorët e kishin menduar mirë se si do t'i shpëto-

nin ndjekës së policisë. Ata dogjën automjetin në rrugën Lushnjë-Berat, në vendin e quajtur "Çukas i Vjetër", ndërsa u gjetën dhe tri armë zjarri. Vrasësit jo rastësisht kishin zgjedhur atë pikë për të humbur gjurmët. Sipas

policisë, tri janë rrugët nga ku mund të jenë larguar Laert Haxhiu e Orges Bilbili dhe miqtë e tyre. E para që të dërgon drejt rrugës nacionale për te Ura Vajgurore e pastaj në qytetin e Beratit. E dyta nga fshati Tashkëz, drejt

RRUGËT

Sipas policisë, tri janë rrugët nga ku mund të jenë larguar Laert Haxhiu e Orges Bilbili dhe miqtë e tyre. E para që të dërgon drejt rrugës nacionale për te Ura Vajgurore e pastaj në qytetin e Beratit. E dyta nga fshati Tashkëz, drejt Krutjes së Poshtme, e më pas humb ndjekja, pasi ka shumë degëzime rrugësh. Dhe pista e cila po monitorohet imtësisht nga uniformat blu është nga fshati Cërraga, rrugë që lidhet me zonën e Dumresë, e më pas shkon në Belësh e përfundon në Cërrik.

Krutjes së Poshtme, e më pas humb ndjekja, pasi ka shumë degëzime rrugësh. Dhe pista e cila po monitorohet imtësisht nga uniformat blu është nga fshati Cërraga, rrugë që lidhet me zonën e Dumresë, e më pas shkon në Belësh e përfundon në Cërrik. Prej katër ditësh, autorët e masakrës së Lushnjës janë personat më të kërkuar në vend, duke angazhuar të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit për kapjen e tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Institucioni i Presidencës

NJOFTIM PËR SHPREHJEN E INTERESIT PËR POZICIONET E KESHILLTAREVE LIGJORE DHE EKONOMIKE PRANE KOMISIONIT PAVARUR TE KUALIFIKIMIT (KPK)

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe vendimit të Kuvendit nr.93/2017, shpall vendet vakante për pozicionet e **keshilltareve ligjore dhe ekonomike** për institucionin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, konkretisht për **keshilltare ligjore (12) dhe keshilltare ekonomike (4)**.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 23-27.10.2017 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së aplikantëve, se bashku me dokumentet perkatëse, pranë institucionit të KPK-se në adresën: **Rruga e Kavajes, Ish-Lidhja e Shkrimtareve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e Hëna-Premte, ora: 09:00-16:00.**
- Kërkesës me shkrim dërguar me postë zyrtare në adresën: **Rruga e Kavajes, Ish-Lidhja e Shkrimtareve, Tiranë.** Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda dates 27/10/ 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga

institucioni përkatës postar. KPK konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

- Kërkesë për aplikim përmes postës elektronike në adresën: komisionipavarurikualifikimit@gmail.com; tek institucioni i KPK-se, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- a) **jetëshkrim profesional**, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- b) **kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njësuara nga organi përkatës, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 22, pika 3 (per keshilltare ligjore) dhe pika 4 (per keshilltare ekonomik) te ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.**

Viktimë e ngjarjes së rëndë, Frank Marku

Aksident fatal në Itali, humb jetën i riu shqiptar

ITALI - Një aksident tragjik ka ndodhur në Itali mbremjen e së shtunës, ku për pasojë ka humbur jetën një i ri shqiptar. Ngjarja e rëndë, siç raportojnë mediat italiane, ka ndodhur rreth orës 22:30 në zonën e Valganna, në komunën Varese. Makina ku udhëtonte Frank Marku, 34 vjeç, ka devijuar dhe është përplasur me mbrojtëset e rrugës. Bashkë me të udhëtonte edhe një fëmijë 13 vjeç, gjendja e të cilit paraqitet e stabilizuar. Përplasja ka qenë

aq e fuqishme, sa thuhet se shqiptari ka fluturuar nga makina e ka përfunduar në asfalt. Ai është transportuar menjëherë në spitalin Circolo, por nuk mundi t'u mbijetonte plagëve dhe ka gjetur vdekjen. Policia italiane ka nisur ndërkohë hetimet për të zbardhur shkakun e aksidentit. Para disa ditësh, një tjetër aksident i rëndë u mori jetën dy shqiptarëve në Itali dhe la të plagosur rëndë një 18-vjeçar që udhëtonte bashkë me ta. Sipas mediave italiane, dy viktimat janë Amir Muslija dhe Ysin Bra-



Viktima, Frank Marku

ha, 22 vjeç, kushërinj me njëri-tjetrin dhe shokë shkolle njëkohësisht. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në rrugën "Siena-Bettolle", në zonën Casetta, afër komunës Castelnuovo Berardenga. Gazeta italiane "La Nazione" publikoi foto dhe video nga ngjarja në makinën e aksidentuar ku udhëtonin tre kosovarët, 21-vjeçarë dhe një 18 vjeçar.

Arrestohet 37-vjeçari moldav

Sherr me thika në Itali, shqiptari plagoset në qafë

ITALI - Një sherr masiv ka ndodhur në orët e natës së mbremshme në Terni të Italisë, ndërsa i plagosur ka mbetur edhe një shqiptar. Mediat italiane shkruajnë se shqiptari, identiteti i të cilit nuk bëhet ende i ditur, ka mbetur i plagosur me thikë në qafë, pas një sherri që kishte pasur me një 37-vjeçar nga Moldavia. Shkak për sherrin ku janë përfshirë disa persona dyshohet të jetë bërë një borxh i pakthyer. Ndonëse kishin sh-

kuar për t'u sqaruar, moldavi ka nxjerrë thikën dhe e ka qëlluar shqiptarin në qafë. I riu është dërguar në spital, ku ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Menjëherë është vënë në pranga edhe i dyshuari për këtë ngjarje, 37-vjeçari nga Moldavia. Dy shqiptarë u përfshirë në një sherr masiv para disa muajsh në Itali në "Sheshin e Dëshmorëve", ku shqiptarët pas një sherri verbal me një maroken, kanë filluar të konfrontohen edhe fizikisht me të. Marokeni është



Vendi ku ndodhi ngjarja

rrahur nga shqiptarët, ndërsa ai ka mundur të shpëtojë duke iukur atyre. Por, ai është pikasur pak më tutje nga një italian, mik i shqiptarëve, ku edhe ky ka filluar ta godasë, duke e lënë të plagosur të riun. Në vendin e ngjarjes ka shkuar policia dhe i riu maroken është shoqëruar për në spital për të marrë ndihmë e parë mjekësore.

Avokati Alban Qafa: Fshirja mund të jetë bërë gjatë kohës që mjeti ishte nën ruajtjen e policisë

Vrasja e Çollakut, eksperti: Të dhënat e GPS së makinës së Shtrazës mund të jenë fshirë

"Një pjesë e të dhënave u nxorën nga karta memorizuese"

Klodiana Lala

Ekspertiza gjermane e pajisjes lokalizuese të makinës me të cilën dyshohet se lëvizte Denis Shtraza mbremjen e rrëmbimit dhe vrasjes së Gazmend Çollakut është bërë objekt debatesh të forta mes palëve në proces. Në dokumentin që disponon "News24", specialisti ngre dyshime për fshirjen e të dhënave të GPS-së së automjetit luksoz. Eksperti sqaron se një pjesë të të dhënave ka mundur t'i nxjerrë jo nga pajisja lokalizuese, por nga karta memorizuese e tij, çka sipas tij ka shumë mundësi që të dhënat e GPS-së të jenë fshirë. Avokati Alban Qafa pretendon se fshirja mund të jetë bërë gjatë kohës që makina ishte nën ruajtjen e policisë, dhe e konsideron këtë si një tentativë për të manipuluar provat. Për këtë, mbrojtësit e të pandehurit këmbëngulën në pyetjen e ekspertit gjerman, kërkesë e cila u rrëzua nga Gjykata për Krime të Rënda. Në fakt, pasi eksperti shqiptar nuk ishte në gjendje të lexonte të dhënat e plota dhe të përcaktonte vendndodhjen e automjetit natën e ngjarjes, edhe prokurori kërkoi pyetjen e specialistit



Viktima, Gazmend Çollaku

të huaj, por më pas u tërhoq. Denis Shtraza është i vetmi i akuzuar për rrëmbimin e 40-vjeçarit Çollaku, i cili, pasi u torturua, u vra dhe u hodh anë rrugës, në Murqin të Krujës, i lidhur këmbë e duar.

NGJARJA
Gazmend (Laert) Çollaku u rrëmbye më datë 06.01.2016. Ai ndodhej i ulur në një lokal në Durrës kur u fut me forcë në një makinë nga 4 persona.

Sipas prokurorisë, dy prej tyre ishin shtetasit Denis Shtraza dhe Ervin Dalipaj. Ndërsa mëngjesin e 7 janarit, Çollaku u gjet i masakruar dhe i vranë në fshatin Murqin të Krujës. Po ashtu, ndaj Shtrazës dhe Dalipajt (i vranë) u ngritën akuzat për veprat penale "Rrëmbim ose mbajtje peng të personit, e parapritur ose e shoqëruar me tortura fizike dhe kur është shkaktuar vdekja e tij", e kryer në bash-



I arrestuari, Denis Shtraza

VRASJA E DALIPAJT
Ish-shëfi i Krimit Ekonomik në Tiranë, Ervin Dalipaj dhe miku i tij Juxhin Dauti u vranë pasditen e 25 prillit të këtij viti në afërsi të vendit të quajtur "Mbikalimi i Sukthit". Ata ishin duke udhëtuar me një automjet tip "Audi" me targa AA 111 OI, kur u qëlluan për vdekje me 32 plumba kallashnikov nga persona ende të paidentifikuar që lëviznin me dy mjete të ndryshme, me një "Audi A3", dhe një "BMW X5" me ngjyrë të zezë.

këpunim, "Prodhim dhe arake" dhe "Mbjajtje pa të drejtë të armeve luft- drejtë të uniformës".



Kërkohej në Itali për prostitucion, 50-vjeçari kapet në Durrës

DURRËS - Policia e Durrësit ka vënë në pranga një person nga Shijaku, i cili ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar. Specialistët për Hetimin e Trafiqeve në Durrës kanë arrestuar shtetasin Riza Sheshi, 50 vjeç, banues në Shijak. Vënia e tij në pranga u bë me qëllim ekstradimin drejt Italisë, pasi Gjykata e Genovës në Itali ka lëshuar urdhër arresti për veprën penale "Pjesëmarrje në organizata kriminale me qëllim shfrytëzim prostitucioni". Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësorë Durrës për veprime të mëte-

VLORE - Një aksident rrugor ka ndodhur pasditen e djeshme në qytetin e Vlorës. Katër makina janë përfshirë në një përplasje mes tyre në vendin e quajtur "Rruga Transballkanike". Burime pranë policisë bënë me dije se si pasojë e përplases mes tyre, një person mbeti i plagosur rëndë, ndërsa personat e tjerë morën dëmtime të lehta. Mësohet se shkak i këtij aksi-



Aksidenti i djeshëm në Vlorë

Aksidenti në Vlorë, 4 makina përplasen me njëra-tjetrën, 1 i plagosur rëndë

denti ka qenë devijimi i një makine, tip "BMW" që është futur me shpejtësi të madhe në rrethrotullim dhe ka përfshirë më pas 4 mjete të tjera. "Salla Operative Vlorë njoftohet se në aksin rrugor të Transballkanikes, në vendin e quajtur "Rrethrotulli-

mi i Omonias", janë përplasar disa mjete. Nga verifikimi paraprak i Policisë ka rezultuar se mjeti tip "BMW", me drejtues mjete shtetasin D.T., 25 vjeç, banues në Vlorë, ka përplasur tri automjete të tjera të parkuara, konkretisht dy mjete tip "Benz" dhe një

tjetër mjet tip "Renault Twingo". I dëmtuar, jashtë rrezikut për jetën ka mbetur vetë drejtuesi i mjetit tip "BMW", i cili ndodhet në Spitalin Rajonal Vlorë duke marrë ndihmën e nevojshme mjekësore", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

Prindërit e 15-vjeçares: Kërkojmë dënimin maksimal. Vajza e autorit: Im atë s'e ka kryer një akt të tillë

POGRADEC

Një vajzë 15-vjeçare së bashku me prindërit e saj ka denoncuar në polici se është përdhunuar nga fqinji 55-vjeçar. Burime pranë policisë bëjnë me dije se vajza me inicialet Xh.B. ka treguar momentet e tmerit që kishte përjetuar, ndërkohë që tashmë është edhe shtatzënë. Sipas vajzës, në momentin që ka ndodhur akti, ajo ka qenë krejt e vetme në banesë. Pas denoncimit, policia vuri në pranga shtetasin Ligor B. Burime policore thanë se përdhunimi i të miturës dyshohet të ketë ndodhur në muajin mars, por ngjarja u zbulua vetëm pas denoncimit të bërë nga prindërit. Pak orë pas arrestimit, Ligor B. mohoi përpara hetuesve akuzat e të miturës, duke i cilësuar ato si stisje, ndërsa këmbënguli të kryhej analiza e ADN-së.

VAJZA 15-VJEÇARE
"Isha vetëm në shtëpi, kur ai hyri në dhomë dhe më përdhunoi. Unë luta të më linte, por nuk u ndal. Kam përjetuar tmerr. Ai është bashkëfshatari im. Embajta të fshehtë ngjarjen, pasi kisha frikë. Kur dyshova se isha shtatzënë, u tregova prindërve. Ata bëjnë denoncimin në polici". Kështu ka deklaruar 15-vjeçarja me inicialet Xh.B., nga fshati Velcan në Pogradec, ku vuri

Përdhunoi e la shtatzënë të miturën, arrestohet 55-vjeçari

Xh.B.: Nuk tregoja se më vinte turp nga fshati, nëna e kuptoi kur m'u rrit barku

në lëvizje policinë. Pas kësaj, blutë vunë në pranga vetëm pak orë më vonë, të dyshuar për ngjarjen e aktit të rëndë, 55-vjeçarin Ligor B. E mitura, nxënëse e klasës së nëntë, u mor në pyetje në prani të psikologes, ku tregoi me detaje tmerin që kishte përjetuar në shtëpinë e saj, kur ishte abuzuar seksualisht nga një burrë që jetonte në të njëjtin fshat e që ishte fqinj me të. E terrorizuar, vajza kishte heshtur, duke mos i treguar askujt për shkak të frikës që kishte nga fjalët që do t'i hapeshin më pas në fshat. "Erdhi në dhomë ku isha dhe më kapi me dhunë. Nuk tregoja se më vinte turp nga fshati. Kur m'u rrit barku, më kuptoi mami. Shkova te infermierja e fshatit dhe më tha që jam shtatzënë. Kërkoj



15-vjeçarja Xh.B.

të dënohet", - tha vajza. Por shtatzënia e saj do të zbulonte për prindërit të vërtetën e hidhur.

DEKLARATAT
Prindërit e 15-vjeçares kërkojmë dënimin maksimal për ngjarjen e rëndë që i ndo-

di vajzës së tyre. "Kërkojmë dënimin maksimal. Na shkatëroi jetën e vajzës. Vajza do e lindë femijën, por do ua lëmë familjarëve të tij ta rrisin. Ne jetojmë në kushte ekstreme", - tha dje për mediat, nëna e 15-vjeçares. Ndërkaq, nga ana tjetër i akuzuari ka thënë në polici se "gjithçka që thuhet është e pavërtetë. Unë jam familjar i rregullt. Kërkoj që të bëhet ADN-ja e femijës, në mënyrë që të zbulohet atësia", - u shpreh ai. Edhe vajza e tij ishte në po të njëjtin version, duke u shprehur se babai i saj është i pafajshëm. "Babai im nuk e ka bërë diçka të tillë. Kjo është e stisur", - ka thënë ajo. Tashmë, 55-vjeçari akuzohet për veprën penale "Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë, me të mitur të moshës 14-18 vjeç".

SHKURT

Aksident në Librazhd, plagoset shoferi

LIBRAZHË - Një aksident me pasojë plagosjen e një personi ka ndodhur dje në afërsi të Librazhdit. Ngjarja ndodhi në aksin Elbasan-Librazhd, në fshatin Labino-Fushë, ku mjeti kamion me targa AA 437 KJ, drejtuar nga shtetasi P.P., 63 vjeç, banues në Shkodër, ka dalë nga rruga. Si pasojë është dëmtuar vetë drejtuesi i mjetit, i cili është dërguar menjëherë për ndihmë mjekësore në spitalin Kirurgjik Elbasan dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Policia mbërriti menjëherë në vendngjarje dhe po kryen veprimet hetimore dhe procedurale.

Disa vatra zjarri në Zvërnec, arrestohet autori

VLORE - Policia e Vlorës ka arrestuar një 58-vjeçar, i cili rezultoi të jetë autori i disa vatrave zjarri në Zvërnec. Në pranga është vënë shtetasi Panajot Rina, i cili nëpërmjet zjarrvënës ka shaktuar dëme të shumta materiale në pronat me ullinj të disa prej banorëve të zonës. Sipas policisë, nga hetimet e kryera nga Specialistët e Seksionit për Krimet në Komisaratin e Policisë Vlorë më datë 14.10.2017, pasi në pronat me ullinj të disa banorëve të fshatit Zvërnec kanë rënë disa vatra zjarri, prej të cilave janë shaktuar pasoja të rënda materiale, ka rezultuar se autor i zjarrvënëve është shtetasi Panajot Rina.

Pranga shqiptarit, kapet me kokainë dhe 1.500 euro

ITALI - Policia italiane ka arrestuar një shqiptar 38-vjeçar, i cili akuzohet për shpërndarje të lëndëve narkotike. Shqiptarit, emri i të cilit nuk bëhet i ditur për shkak të hetimeve, iu sekuestruan nga policia brenda shtëpisë 380 gramë kokainë, materiale për paketim të lëndëve narkotike si dhe 1.500 euro. Nga policia është bllokuar gjithashtu edhe një peshore, 10 karta SIM, si dhe 6 aparate celularë. Sipas medive italiane, mësohet se 38-vjeçari shqiptar është person me precedentë të mëparshëm penalë.

Droga ishte e ndarë në 60 pako

Sekuestrohen 67.5 kg kanabis, në kërkim 3 trafikantët



Droga e sekuestruar

SHKODËR - Policia e Shkodrës ka sekuestruar 67.5 kg lëndë narkotike kanabis sativa, ndërsa në kërkim janë shpallur 3 persona. Shërbimet e Policisë Kufitare, gjatë patrullimit në kufirin jeshil, në orët e para të mëngjesit të djeshëm kanë konstatuar tre shtetas, të cilët po lëviznin në drejtim të kufirit me Malin e Zi dhe secili po transportonte nga një thes ku dyshohej se kishte lëndë narkotike. Tre shtetasit që transportonin lëndën narkotike, sapo kanë parë se po ndiqeshin nga Policia, në vendin e quajtur Raps, Malësi e Madhe, kanë fshehur thasët me drogë në shkurre dhe duke shfrytëzuar kushtet e errësirës dhe terrenin e thyer malor janë larguar në thellësi të kufirit me Malin e Zi. Policia Kufitare gjatë kërkjes së zonës ka gjetur dhe sekuestruar 3 thasë, ku brenda të cilëve kishte 60 pako me peshë 67.5 kg kanabis sativa. Pas kësaj, policia nisi punën për të bërë të mundur identifikimin dhe kapjen e autorëve të dyshuar dhe vënien e tyre para përgjegjësisë penale. Materialet i kaluan Prokurorisë për Krimet e Rënda Tiranë, për veprën penale "Trafikim i narkotikëve, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë".

Mediat italiane: I shumëkërkuari jetonte në bunker

Gjykata e Lartë lë në "arrest me burg" Alket Hatinë, i dënuar nga Italia për drogë

Gjykata e Lartë ka lënë në fuqi masën e sigurisë "arrest me burg" për Alket Hatinë, i cili është dënuar nga drejtësia italiane me 20 vite burg. 43-vjeçari u arrestua në 8 korrik nga policia në Durrës, por u la i lirë pas 3 ditësh nga Gjykata e Shkallës së Parë me argumentin se e kishte vuajtur një herë këtë dënim. Disa ditë më vonë, Apeli i Durrësit vendos të rikthejë në burg Hatinë, i cili nuk gjendej nga policia në adresën që kishte dhënë. Rekursin në Gjykatën e Lartë e kishte bërë mbrojtja e të shpallurit në kërkim, e cila kërkoi të shpallet i paligjshëm ekstradimi drejt Italisë. Alket Hatia është arrestuar në vitin 2008 në vendin tonë dhe ka kryer 6 vite burg, duke u liruar në vitin 2014. Në vitin 2015, Gjykata e Milanos e dënoi me 20 vite burg. Mbrojtja e tij pretendon se është dënuar për të njëjtin episod për të cilin klienti i tyre e ka kryer burgun. Sipas prokurorisë italiane, në vitet 2003-2004 Hatia është arrestuar në



Alket Hatia

Milano me 350 kilogramë heroine dhe 190 kilogramë kokainë. Vlera e drogës kapte shifrën e rreth 40 milionë eurove. Ndërkaq, pas arrestimit në Shqipëri të të shumëkërkuarit Alket Hatia, mediat italiane zbardhën detaje të reja për 43-vjeçarin, që konsiderohej si një nga bosët më të mëdhenj të trafikut të drogës. "Ansa" shkruante se Alket Hatia fshihej në një vilë-bunker në zonën e Beratit dhe lëvizte i rrethuar nga rojet,

ndërsa u arrestua në Durrës teksa do të takonte një mikun e tij. Sipas medive italiane, shqiptari nga janari i 2003-shit kishte trafikuar në qytetin e Milanos rreth 350 kg heroinë e 190 kg kokainë, me vlerë 35-40 milionë euro. Sipas hetuesve, ai fliste pak në telefon dhe askush nuk e thërriste kurrë në emër, ndërsa droga vinte nga Shqipëria nëpërmjet anijeve, makinave e kamionëve.

SHKRIMTARET DIKTATURA

EKSKLUZIVE / Së shpejti libri më i ri "Shkrimtarët dhe artistët në diktatin komunist..." i gazetarit dhe studiuesit të njohur, Dashnor Kaloçi

Kapllan Resuli, Enverit: Më merrni në mbrojtjen tuaj, jam viktimë e UDB

Zbulohet letra e shkrimtarit dërguar diktatorit në vitin 1971, kur ai mbahej i izoluar në qeli

Dashnor Kaloçi

Nga fundi i vitit 1948, kur Enver Hoxha prishi dhe ndërpreu marrëdhëniet tejet miqësore me Jugosllavinë e Marshallit Josif Broz Tito, me të cilin ishte lidhur ngushtë që nga viti 1941, (kur ata e ndihmuan për krijimin e Partisë Komuniste dhe zgjedhjen e tij në krye të saj) dhe, gjithashtu, largimin e Beogradit nga Blloku i Lindjes që kontrollohej nga Moskë, në drejtim të Shqipërisë filluan të vinin mjaft shtetas jugosllavë që e konsideronin veten besnikë të Stalinit dhe ishin kundër politikës së liderit të tyre të cilin e akuzonin si revizionist dhe "të shtitur me Shqipërinë perëndimore". Po në këtë kohë, krahas shtetasve jugosllavë, në drejtim të kufirit me Shqipërinë filluan të vinin ilegalisht edhe mjaft shtetas jugosllavë me kombësi shqiptare që banonin në viset e tyre të trevave shqiptare, si: Kosovë, Mali i Zi dhe Maqedoni, të cilët detyroheshin të largoheshin nga vatrat e tyre për shkak të kllimës politike antishqiptare që po ndërmerre regjimi titist pas prishjes së marrëdhënieve me Shqipërinë e vendet e Bllokut Lindor në përgjithësi. Ardhja e shqiptarëve të Jugosllavisë në Shqipëri filloi të bëhej me e dendur sidomos pas vitit 1955 kur Beogradi zyrtar dhe Ankaraja nënshkruan marrëveshjen tashmë të njohur, Tito-Bajar (Xhelal Bajar, presidenti i Turqisë në atë kohë), për shkëmbimin e ndërrojllë të shtetasve të tyre. Kështu që në atë periudhë kohe e në vazhdim, deri nga fundi i viteve '60-të, edhe për shkak të politikës antishqiptare dhe persekucionit e gjenocidit, që ndiqte ndaj tyre regjimi i Beogradit (i zbatuar nga Rankoviçi), nga Jugosllavia për në Shqipëri erdhën ilegalisht një numër i konsiderueshëm shqiptarësh, të cilët fillimisht u sistemuan nëpër disa kampe si ai i Llakatundit të Vlorës, etj. Në këto kampe, ata patën një jetë tejet të vështirë, duke punuar e jetuar njësoj si të internuarit e tjerë shqiptarë në fshatrat e Myzeqesë, si Savër, Shtyllas, Shegëz, Bedat, Plug etj. Ndër ata shqiptarë të Kosovës, Malit të Zi e



Kapllan Resuli

Maqedonisë që erdhën asokohe në Shqipëri, janë më të njohur disa prej tyre si: Gani Demiri Ratkoceri, Zef Gjeloshaj, Preloc Margilaj, Kapllan Resuli, Pashko Camaj, Esat Myftari, Sadri Ahmeti, Namik Luca, Ded Berisha, Hil Kamani, Selim Kelmendi, Shefqet Kelmendi, Estref Kelmendi, Agim Gjakova etj., shumica e të cilëve u dha e drejta dhe ndoqën shkollat e larta në Tiranë, duke u diplomuar kryesisht në Fakultetin Filologjik.


Por edhe pse ata fillimisht arritën që të integroheshin në atdheun e tyre amë, me ndonjë përjashtim të vogël, pjesa më e madhe e tyre u arrestuan dhe u dënuan me burgime të gjata, duke u akuzuar si agjentë të UDB-së etj. (Pati prej tyre edhe që vdiqën në burgje, si p.sh. arsimitari Selim Kelmendi, në burgun e Burrelit në vitet '80-të). Diskriminimi dhe persekutimi i tyre fillonte që në kufi kur ata dorëzoheshin pranë autoriteteve zyr-

tare shqiptare të Ministrisë së Brendshme dhe më pas kur ata detyroheshin të kalonin nëpër një filter të hollë, si në Degët e Punëve të Brendshme në rrethet kufitare ku ata vinin, apo më pas në vendet ku i dërgonin, si në rrethet e Krujës, Beratit, Fierit, Vlorës etj. Madje, asokohe e deri në fundin e viteve '80-të kur edhe u rrëzua regjimi komunist, për shqiptarët e Jugosllavisë që vinin në atdheun amë, ka pas ekzistuar një "Qendër filtrimi", e cila ndodhej në periferi të qytetit të Laçit, e cila njihej si Kulla e Gjeneral-Previzit (pronar i saj, ish-Komandant i Mbrojtjes Kombëtare në vitet 1943-'44), ku ata i mbanin të izoluar për muaj me radhë deri sa Sigurimi i Shtetit kryente verifikimet e nevojshme dhe vendoste për ta; për t'i kthyer përsëri në Jugosllavi, apo për t'i mbajtur e sistemuar në Shqipëri. Ndryshe ndodhte me shtetasit jugosllavë (me kombësi jugosllave) që vinin në Shqipëri duke kërkuar strehim politik si antititistë dhe stalinistë, të cilët mbahehin dhe trajtoheshin në kushte mjaft më të mira se kosovarët që vinin këtu. Madje ata kishin edhe një gazetë të tyre si dhe një emision posaçërisht



Enver Hoxha

për ta në Radio Tiranë. Diferencimi e emigrantëve jugosllavë me ata kosovarë nuk kishte të krahasuar jo vetëm nga kushtet ekonomike, por edhe politikisht, pasi kreu i tyre, ishte i ftuar në çdo kongres të Partisë së Punës së Shqipërisë, ku përshëndete nga tribuna përkrah Enver Hoxhës?! Ashtu siç theksuam pak më lart, ndër ata dhjetëra shqiptarë të Kosovës, Malit të Zi dhe Maqedonisë që erdhën në Shqipëri, pjesa më e madhe e tyre patën një fat tragjik, duke përfunduar burgjeve dhe internimeve të regjimit komunist të Enver Hoxhës, saqë për ta që në atë kohë hapur apo nën zë thuhej; "Ikn nga shiu dhe ranë në breshër". Një nga ata që patën këtë "fat", është dhe Kapllan Resuli, (me origjinë nga Ulqini dhe i shkolluar e diplomat në Prishtinë e Beograd), i njohur që në fundin e viteve '60-të, kur atij iu botua romani "Tradhëtia", i cili bëri bujë të madhe. Kapllan Resuli, i cili ishte vendosur me banim në rrethin e Lushnjës ku dhe punonte si arsimtar, dikë nga viti 1971, u arrestua me akuzën tashmë të njohur, "agjent i UDB-së", dhe vuajti për shumë vjet në burgjet politike të regjimit komunist të Enver Hoxhës. Ashtu siç do të shohim edhe nga ky dokument arkivor që publikohet për herë të parë në faqet e këtij libri, ndërsa shkrimtari Kapllan Resuli mbahej i izoluar në hetuesi në kushte çnjerëzore, në një moment të një dëshpërimi të thellë dhe i bindur në pafajësinë e tij, ndoshta dhe idealist, ai detyrohet që t'i shkruajë një letër në formë lutje Enver Hoxhës?! ku pasi i argumenton shkurtimisht se është i pafajshëm, se në shtëpi e presin dy fëmijët e tij të vegjël që me arrestimin e tij kanë mbetur jetimë, Resuli i kërkon mbrojtje personale Enver Hoxhës?! Madje ai i shkruan atij, e bardhë në të zezë, se lidhur me arrestimin e dënimin që po i bëhej, mund të ketë gisht UDB-ja...?! Gjë e cila as më pak dhe as më shumë ishte një akuzë tejet e rëndë që behej prej Resulit, që indirekt implikonte Sigurimin e Shtetit me UDB-në, në një bashkëpunim të tyre. Por edhe sa më sipër, ajo që bie në sy është fakti se lidhur me këtë gjë, nuk ka asnjë reagim me shënime përkatëse në letrën në fjalë, siç ka →





Letra t'i jepet për ta parë shokut Kadri dhe të mbesë në arshiva pa i dhënë përgjigje. Megjithatë çështjen e tij e kanë organet e drejtësisë dhe ta ndjekin ato deri në fund të skjarorjve të vërtetën.

Hysni Kapo
20/V/1971

Sekretariatit të parë të Komitetit Qendror të PPSH-së

Shokut Enver Hoxha
Tiranë
Lutje

I nëshkruari Kapllan Resulli, shkrimtar kosovar nga Ulqini, i arratisur nga Jugosllavia në R.P. të Shqipërisë në vitin 1960 si emigrant politik, i martuar me dy fëmijë të vegjël që tani kanë mbet jetimë se jam i arrestuar në burgun Nr.313 të Tiranës, ju parashtroj këtë lutje si vijon:

Pardje hetuesi më dorëzoi aktakuzën dhe kështu m'u bë e qartë se organet e pushtetit dashkan me më nxjerrë në gjyq.

Jam i pafajshëm, se edhe ato gabime që mund të kem, nuk kanë karakterin e ndonjë veprimtaria armiqësore, por janë rezultat i një trajtimi jo të drejtë që më asht ba që nga dita e ardhjes në R.P. të Shqipërisë, janë rezultat i provokimeve të vazhdueshme, të një intrige monstruoze që asht kurdis kundra meje dhe të nxitjeve të hapura që më janë ba për të ba gabime edhe ma të randa, faje që unë fatmirësisht nuk i kam ba, tue pas besim te Partia dhe tue shpresua se një ditë Partia do të vejë dorë në këtë trajtim që po më bahet dhe do të më marrë nën mbrojtjen e saj.

Cashtja ma nuk pret. Prandaj po ju drejtohem që të më merni në mbrojtjen Tuej personale, të anuloni procesin gjyqësor dhe të caktoni një komision për rishqyrtimin e çashtjes sime.

Po ju drejtohem me këtë lutje e me bindje se në trajtimin që më asht ba, në intrigën që asht kurdis kundër meje, mund të ketë gisht UDB-a, por jo edhe Partia e Punës Shqiptare.

Edhe njëherë po e përsëris se jam i pafajshëm dhe se për këtë gjajam në gjëndje të parashtroj edhe prova të pakontestueshme.

Dëshiroj që të vazhdoj punën

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....



.....

.....

.....

.....

.....



← tjera të të dënuarve politikë në atë kohë?! Por ashtu si në mjaft raste të tjera, siç dhe bëhet e ditur nga dokumenti në fjalë, letra e shkruar me aq shpresë nga Kapllan Resulli, nuk i ka rënë kurrë në dorë Enver Hoxhës. Sipas shënimit që ka lënë Hysni Kapo më dorën e tij në shkresën shoqëruese përkatëse të letrës së Resullit, "Shoku Enver nuk merret me letrat e të burgosurve dhe çështjen e tij e kanë në dorë organet e drejtësisë..."?! Dhe pas këtij shënimi, letra e Resullit i është kthyer përsëri ministrit të Brendshëm, Kadri Hazbiu, njeriut që kishte vendosur dhe ekzekutuar arrestimin e tij, natyrisht duke marrë më parë dhe aprovimin e firmën e Hysni Kapos, sekretarit përkatës të Komitetit Qendror të PPSH-së, (që mbulonte organet e Diktaturës së Proletariatit), i cili zbatonte me përpikëri vijën politike të Enver Hoxhës. Gjë e cila e mbyllte dhe i "vinte kapak" çështjes Resulli, duke bërë që ai të vuanet për vite me radhë burgjeve dhe infernimeve të atij regjimi diktatorial, bashkë me mjaft shkrimtarë dhe artistë të

tjerë nga atdheu amë. Ashtu si dhe pjesa më e madhe e dokumenteve të këtij libri, edhe kjo letër e Kapllan Resullit dhe shkresat e tjera shoqëruese, botohen të plota dhe pa asnjë shkurtim.

Kapllan Resulli
Shokut Hysni
Reparti 313 Tiranë

Kërkon të merret nën mbrojtje nga shoku Enver e të shkarkohet nga akuzat që i kanë ngritur. Ndotëhet i arrestuar dhe i është dorëzuar akuzat për të dalë në gjyq. Si arrestimin dhe akuzën i quan të padrejta e pa asnjë bazë. Thotë se s'ka kryer asnjë krim dhe se ato që i atribuohen janë intriga të kurdisura. Lutet të caktohet një komision të rishqyrtojë çështjen e tij e do të dali ashtu si mendon ai. Thotë se dënimi i tij do të ketë pasojë për shtetin shqiptar e sidomos për çështjen kosovare. Mendon se në këtë çështje të kurdisur do të ketë gisht UDB-ja.

(Shënimi i Hysni Kapos)
Shoku Enver nuk merret me çështje të të burgosurve.

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....


.....

.....

.....

.....

.....



Kapllan Resulli

time si shkrimtar në gjirin e kombit shqiptar dhe nën flamurin e Partisë së Punës të Shqipërisë.

Kujdesi Juej për mue do të më bajë të mundun këtë gjaj, kurse dënimi i pameritum që po pregaditen me më dhanë mbas gjithë atyne vuetjve, sakrificave dhe të atij kontributi që i dhashtë kombit e atdheut shqiptar, Partisë së Punës të Shqipërisë, do të më shkatërrtojë familjen dhe do të më marrë në qafë jo vetëm mue, por edhe ata dy fëmijë të mitun, Arbenin dhe Arbanën. Nga ana tjetër dënimi i pameritum do të ketë pasojë të damëshme edhe për kombin e atdheut shqiptar, edhe për partinë, e veçanërisht për çashtjen e Kosovës. Unë nuk e dëshiroj këtë gjaj, prandaj edhe po ju drejtohem me këtë lutje.

Me shpresë dhe me nderime

Tiranë
Më.6.V.1971
Shkrimtari kosovar
Kapllan Resulli

.....

.....

.....

.....

.....

.....
PARTIA E PUNES
SHQIPERISE
KOMITETI QENDROR
Tiranë, më 26 / 5 / 1971
Nr. K 96/1 Prot.

LANDA: Dërgohet letra e Kapllan Resullit

MINISTRISHE SE PUNEVE TE
BRENDESHME
(Shokut Kadri Hazbiu)
TIRANE

Me porosi të shokut Hysni Kapo ju dërgojmë për të parë letrën që i drejton shokut Enver i quajturi Kapllan Resulli.

Pasi të mbaroni punë, letra të kthehet pa i dhënë përgjigje të interesuarit.

E NGARKUAR ME PUNEN E
LETRAVE DHE ANKESAVE
Vangjelo Sotiriadhi
Shoku Kadri e pa dhe e ktheu letrën

a-a 1.5.71
Lidhje kop 1

Luiza Gega, fituese e garës në 21 km, Bledar Suxha kryeson kategorinë "WE Too"

Maratona e Tiranës pret 2500 vrapues

Veliaj merr çmimin e mirënjohjes për organizimin

Voltiza Duro

Ditën e djeshme u zhvillua për të dytin vit radhazi Maratona e Tiranës, ku morën pjesë 2500 vrapues nga 40 vende të ndryshme të botës. Ky event u organizua nën kujdesin e Bashkisë së Tiranës dhe Federatës Shqiptare të Atletikës. Nisja e këtij aktiviteti sportiv u bë nga sheshi "Nënë Tereza" dhe përshkoi pikat më kryesore të kryeqytetit. Edhe kryebashkiaku, Erion Veliaj u bë pjesë e kësaj maratone dhe deklaroi se ky event konsiderohet si një ngjarje fantastike. "Ka qenë një përgatitje fantastike. Shpresoj të dalë më mirë se vjet, megjithatë dua që gjithashtu t'u japim një duartkrojtje atyre që s'janë këtu, por janë 660 vullnetarë, janë 400 policë, janë plot zjarrfikës, shërbimet emergjente, plot pastrues dhe mirëmbajtës që kanë bërë një punë fantastike", - tha ai para nisjes së garës.

MASAT

Policia Bashkiakë e Tiranës, në bashkëpunim me policinë Rrugore morën një sërë masash për sigurinë dhe mbarëvajtjen e maratonës, ku u angazhuan rreth 300 punonjës. Ditën e djeshme janë ndëshkuar plot 78 drejtues automjete, pasi kanë shkelur rregullat.



Kryebashkiaku, Erion Veliaj gjatë dhënies së çmimit

Kategoritë pjesëmarrëse në maratonë ishin "Fun Run", "We too", "Half Marathon" dhe "Tirana 10K". Pjesë e kategorisë "Fun Run" ishin nxënësit e shkollave të Tiranës, të cilët vrapuan në rrugët e qytetit duke mbaruar një mesazh sensibilizues: "Edukimin e brezave nëpërmjet sportit". Kategoria "We Too" mirëpriti të gjithë individët me aftësi

ndryshe, duke i parë si shembull motivimi. Ndërsa, "Half Marathon" (21, 0975 km) dhe "Tirana 10K" (10 km), ishte e hapur për të gjithë qytetarët mbi moshën 18 vjeç, shqiptarë dhe të huaj, profesionistë dhe amatorë. Abel Kibet Rop dhe Luiza Gega ishin fituesit e garës në 21 km, Edwin Cheruiyot Melly dhe Olena Popova ishin fituesit

e garës në 10 km, dhe Bledar Suxha u shpall fitues i garës "We Too" (gara për personat me aftësi të kufizuara). Ashtu siç edhe kishin premtuar pak ditë më parë publikisht, kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj arriti të thyejë rekordin e tij të një viti më parë. Ai garoi në kategorinë 10 km, të cilën e përshkroi për 59 minuta e 05 sekonda.

Kampioni shqiptar i Ballkanit merr pjesë në Maratonën e Tiranës

Pjesëmarrës në Maratonën e Tiranës ka qenë edhe 23-vjeçari nga Lezha David Nikolli, i cili është shpallur kampioni Ballkanit në atletikë për garat 3000 metra. Ai tregon për "Gazeta Shqiptare" se ditën e djeshme u renditi i katërti dhe se lumturia e tij më e madhe është të përfaqësojë Shqipërinë në kompeticionet ndërkombëtare. "Prej 8 vitesh jetoj në Itali dhe deri më tani kam arritur të jem i pari në 4 kampionate ndërkombëtare të atletikës. Në vitin 2018 do të marr pjesë në kampionatin europian, që do të zhvillohet në Berlin të Gjermanisë, dhe po në këtë vit do të kem mundësinë të përfaqësoj vendin tim në Kampionatin e Olimpiadës në Tokio të Japonisë", - tregon atleti për "GSH".

Gjithsesi, ndonëse nuk arriti të marrë një çmim si garues në maratonë, Veliaj u vlerësua me një çmim të veçantë nga Federata e Atletikës për iniciativën dhe organizimin e maratonës. Ishte presidenti i Federatës Shqiptare të Atletikës, Gjergj Ruli ai që i dorëzoi kryebashkiakut çmimin e mirënjohjes për kontributin e dhënë në or-

ganizimin dhe mbarëvajtjen me sukses të kësaj maratone. "Unë e theva rekordin tim, nuk mora ndonjë çmim për rezultat të lartë, por unë besoj se është si puna e Tiranës: rëndësi ka që çdo vit të jemi pak më mirë se vitin që kaloi. Nëse vazhdojmë me këtë mënyrë, besoj se do e kemi qytetin e ëndrrave tonë", - theksoi Veliaj gjatë marrjes së çmimit.



Call for: Engineering Company to provide supervisory works for the rehabilitation of four Health Centres in Fier region

Health for All Project in Albania (HAP) is funded by Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) of the Swiss Government and is being implemented by Health for All Centre in Fier and Diber Regions. Its overall goal is that the Albanian population, including the most vulnerable, benefit from better health due to improved primary health care services and health promotion activities.

To improve conditions for health workers and users in four Health Centres in Fier, HAP Centre will contract an engineering company, here in called **The Contractor**, to do the rehabilitation in those Centres. To supervise the **Contractor's** works, HAP Centre will contract an engineer Company, herein called **The Provider**, to supervise the rehabilitation works as described in the TOR in the below link:

<https://drive.google.com/file/d/0B4R3Io0APoIbNGtQRmVFNOt6Tms/view>

The offer should include:

1. A financial offer specifying only the supervisor-day fee and transportation cost;
2. CV of the bidder, CV of the Directors of the Company and its technical team, with details of their field of engineering, and detailed description of previous works similar to the ones expected under this TOR;
3. Names of three references of similar works, from which HAP can get information on the qualification of the bidder;
4. Licenses and registrations proving that the bidder is duly accredited and certified for carrying out the works described in the TOR

Those submitting an application should be aware that, if selected and contracted, they will be required to issue invoices (VAT or A4).

Deadline for application

The offers must be delivered by **25 October 2017** in sealed envelopes and with clearly marked "Public Invitation to Tender for Engineering Company" to:

Procurement Team
HAP Centre
Rruga "Themistokli Germerjini", Pallati Helios, Kati II, Ap.1, Tirana, Albania
E-mail: info@hap.org.al; www.hap.org.al

*Please note that the shortlisted applications will be contacted within 08 November 2017.



Në pranga 2 inspektorë, abuzim me detyrën

Monitorimi i AKU, mbyllet 28 thertore në vend pasi nuk plotësonin standardet

Gjatë tri ditëve të fundit, 28 thertore në vend janë mbyllur pasi nuk plotësonin kushtet higjienosanitare dhe detyrimet e tjera të përcaktuara. Në kuadër të nismës për reformimin e plotë të gjithë zinxhirit të sigurisë ushqimore në vend, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka kryer 29 inspektime në lidhje me kushtet e tregimit të mishit dhe therjes së kafshëve. "Janë mbyllur 28 pika therjeje në të gjithë vendin, ndërsa për një subjekt është lënë detyra për plotësimin e disa kushteve. Të gjitha rastet e mësipërme të cilat janë mbyllur nuk garantojnë as minimumin e standardeve të parashikuara me ligj", thuhet në njoftimin e AKU-së. Kështu, pas monitorimit, janë mbyllur 3 pika therjeje në Tiranë, 1 punishte qoftesh dhe 1 pikë e tregimit të mishit, si dhe 1 është paralajmëruar. Gjithashtu janë mbyllur 4 pika therjeje në qarkun Gjirokastrë, 2 në Berat, 2 në Dibër, 1 në qarkun Elbasan dhe 1 subjekt është paralajmëruar. Ndërsa, është ndaluar aktiviteti edhe për 4 thertore në qarkun Fier, 1 në qarkun



Lezhë, 1 në qarkun Kukës, 1 në Shkodër, dhe 4 të tjera janë mbyllur nga Drejtoria Rajonale e Qarkut Vlorë. Ndërkaq, pas denoncimit të Drejtorisë së Përgjithshme të AKU-së, dy inspektorë të Drejtorisë Rajonale të AKU-së në kryeqytet janë vënë në pranga nën akuzën "Abuzim me detyrën dhe shkelje të ligjit", pasi kishin licencuar një pikë therjeje në fshatin Baldushk, e cila nuk plotësonte asnjë kriter ligjor. "Autoriteti Kombëtar i Ushqimit garanton se ky nuk është një aksion, por një punë e filluar, e cila përfundon vetëm me reformimin e plotë të gjithë zinxhirit të sigurisë ushqi-

28

THERTORE

Pas inspektimit nga AKU-ja, 28 thertore në vend janë mbyllur pasi nuk plotësonin kushtet higjienosanitare dhe detyrimet e tjera të përcaktuara. Gjithashtu, janë mbyllur 3 pika therjeje në Tiranë, 1 punishte qoftesh dhe 1 pikë e tregimit të mishit. Më tej janë mbyllur 4 pika therjeje në qarkun Gjirokastrë, 2 në Berat, 2 në Dibër, 1 në qarkun Elbasan dhe 1 subjekt është paralajmëruar.

more në vend. Çdo tentativë për të rihapur aktivitetin e mbyllura do të ndëshkohet maksimalisht, ndërsa kujton se në shtën e tij do të jenë të gjitha thertoret dhe njësitë e tjera të tregimit të mishit", - citohe në njoftimin e AKU-së.

ZGJEDHJET/ Maqedonia votoi dje për pushtetin e ri lokal

Partitë shqiptare të përcara në votime, Ali Ahmeti: BDI do të fitojë

Gara në vend zhvillohet për komunat

Egla Xhemali

MAQEDONI

Në Maqedoni u zhvilluan dje, zgjedhjet për pushtetin e ri lokal në 80 komuna dhe në Shkup, si njësi e veçantë e pushtetit vendor, i cili në përbërjen e tij ka dhjetë komuna, dy prej të cilave janë me shumicë shqiptare. Të drejtën e votës e kanë 1.814.644 qytetarë, të drejtë që mund ta realizojnë në 3480 vendvotime. "REL" raportoi se në garën për të parin e komunës morën pjesë 260 kandidatë të 19 partive politike dhe të koalicioneve të ndryshme, përfshirë edhe kandidatët të pavarur. Zgjedhjet u organizuan dhe realizuan nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, i cili bëri thirrje për proces demokratik zgjedhor. "KSHZ-ja kërkon nga të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje, nga administrata zgjedhore, partitë politike, qytetarët, që të sigurojnë zgjedhje korrekte dhe demokratike, duke respektuar Kushtetutën dhe ligjet në fuqi. Qytetarët presin nga KSHZ-ja dhe nga administrata zgjedhore të sigurojnë zgjedhje korrekte dhe demokratike, të cilat janë

kusht për përparim të mëtejshëm të Republikës së Maqedonisë", - ka deklaruar kryetari i KSHZ-së, Aleksandar Çiçakovski. Beteja kryesore në këto zgjedhje zhvillohet mes dy blloqeve politike maqedonase dhe shqiptare; të partitë maqedonase mes LSDM-së së kryeministrit, Zoran Zaev në pushtet dhe VMRO-DPMNE-së opozitare, të cilat në zgjedhjet e fundit parlamentare në dhjetor të vitit të kaluar kishin një rezultat thuajse të barabartë, me dy mandate më shumë në favor të partisë së ish-kryeministrit Nikolla Gruevski. Dy partitë forcat i kanë përçuar në Shkup, që përbën thuajse gjysmën e trupit zgjedhor, por edhe në qytetet e tjera më të mëdha, si në Manastir, Kumanovë, Prilep, Shkup, Strumicë dhe Ohër. Te partitë shqiptare beteja zh-



Foto ilustruese

villohet mes BDI-së, që është pjesë e pushtetit qendror, dhe dy partive opozitare, Lëvizjes Besa dhe PDSH-së, por edhe Aleancës për Shqiptarët, e cila, megjithëse është në koalicionin qeveritar, edhe ajo në këto zgjedhje sfidon BDI-në. Kreu i BDI-së, Ali Ahmeti ka deklaruar se shqiptarët janë të përcarë, por pavarësisht kësaj ai është

të i bindur se partia e tij do të fitojë shumicën e komunave shqiptare. Gara kryesore mes partive shqiptare zhvillohet për Çairin (komunë e Shkupit), Tetovën, Gostivarin, Strugën, Dibërën dhe rreth dhjetë komuna të tjera rurale. Në Kërçovë, nga partitë shqiptare merr pjesë vetëm kandidati i BDI-së, pasi partitë e tjera janë

tërhequr nga gara për të mos rrezikuar - siç kanë thënë këtë - që të humbet nga shqiptarët. Zgjedhjet zhvillohen në dy rrethe zgjedhore, por ato mund të përfundojnë edhe me një rreth nëse ndonjëri nga kandidatët fiton mbi 50 për qind të votave; në të kundërtën, dy kandidatët me më shumë vota kalojnë në rrethin e dytë, që mbahet pas dy javësh. Procesi zgjedhor mbikëqyret nga rreth 5 mijë vëzhgues vendorë dhe rreth 400 të huaj. Numrin më të madh të vëzhguesve e ka asociacioni qytetar "Most", rreth 2500, që do të mbulojnë 50 për qind të vendvotimeve. Procesi zgjedhor do të zhvillohet nën masa të shtuara sigurie. Nga Ministria e Punëve të Brendshme kanë bërë të ditur se të gjitha 3840 vendvotimet do të ketë forca policore për të sig-



ALI AHMETI

Partitë shqiptare në Maqedoni shkuan në votime të përcara. Një rëndësi e madhe në këto zgjedhje iu dha komunave si ajo e Çairit (komunë e Shkupit), Tetovës, Gostivarit, Strugës, Dibërës dhe rreth dhjetë komunave të tjera. Për të gjitha subjektet politike shqiptare këto zgjedhje shihen si një test i ri. Kreu i BDI-së, Ali Ahmeti ka deklaruar se shqiptarët janë të përcarë, por pavarësisht kësaj ai është i bindur se partia e tij do të fitojë shumicën e komunave shqiptare.

ruar mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Analistët besojnë se politika shqiptare në Maqedoni duhet të jetë më e bashkuar se kurrë në një kohë që përcarja e shqiptarëve ka arritur kulmin, pasi uniteti mes tyre do të jetë në të mirë të mbarë komunitetit shqiptar që jeton atje.



INVITATION TO TENDER

REHABILITATION of Health Center in Fier

The Health for All Project in Albania (HAP) is funded by Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) of the Swiss Government and is being implemented by HAP Centre. Its overall goal is that the Albanian population, including the most vulnerable, benefit from better health due to improved primary health care services and health promotion activities.

HAP will rehabilitate the Health Center in Patos, in the Municipality of Fier. In the context of this initiative, HAP Centre is requesting offers from companies interested in carry out those rehabilitation works. The required documents, forms, technical specifications and annexes for the bidding can be found in the HAP web site link

<https://drive.google.com/drive/folders/0B4R3lo0APolbcSVNURJF5aGZldUd>

The interested Companies should express their interest in participating in this tender by sending an email to info@hap.org.al until 16th October 2017.

The interested Companies must participate in the site visit to take place within October 2017. The details of place and time of the visit will be given to the interested Companies on the 17th October 2017.


The bidding Companies should submit their offers to HAP Centre no later than end of business day on the 10th November 2017.

The offer should include:

1. Letter of interest;
2. The BoQ Excel sheet provided with the tender documents, filled with the respective prices and totals (BoQ template provided in Annex 2);
3. The financial offer in correspondence with the subtotals and total amounts in the BoQ (Format provided in Annex 2);
4. CV of the company (with proves of the experience of the company in carrying out similar works);
5. CVs of directors of the Company;
6. CV of technical team directly responsible for the coordination of the works and to will be deployed to do the work sites (see Annex 4.2 and Annex 4.3);
7. The time table of the works with a brief narrative of the timing and sequence of the jobs to be carried out (see Annex 4, Annex 4.1.1 and Annex 4.1.2);
8. Copy of the registration and license of the company;
9. Copy of its status with the tax authorities and confirmation of Tax Authorities for having No obligations;
10. Document from the bank as a proof of its commercial links and sound finance (within the required limit for such works);
11. For the preparation of the offers, the companies will be obliged to visit the site, verify and make its own measurements; a short report of the visit should be added to the offer.

The application should be sent in sealed envelope no later than end of business day on the 10th November 2017 to the address:

Subject: REHABILITATION OF HEALTH CENTRE OF PATOS IN FIER REGION
Procurement Team
HAP Centre
Rruga "Themistokli Germeji", Pallati Helios, Kati II, Ap.1, Tirana, Albania
E-mail: info@hap.org.al; Website: www.hap.org.al



Swiss Agency for Development and Cooperation SDC



INVITATION TO TENDER

REHABILITATION OF Health Center in Roskovec

The Health for All Project in Albania (HAP) is funded by Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) of the Swiss Government and is being implemented by HAP Centre. Its overall goal is that the Albanian population, including the most vulnerable, benefit from better health due to improved primary health care services and health promotion activities.

HAP will rehabilitate 3 Health Centers in Kurjan, Strum and Roskovec in the Municipality of Roskovec, in Fier Region. In the context of this initiative HAP Centre is requesting offers from companies interested in carry out those rehabilitation works.

The required documents, forms, technical specifications and annexes for the bidding can be found in the HAP web site link

<https://drive.google.com/open?id=0B4R3lo0APolbcEc2T0tuS1RqVm8>

The interested Companies should express their interest in participating in this tender by sending an email to info@hap.org.al until 16th October 2017.

The interested Companies must participate in the site visit to take place within October 2017. The details of place and time of the visit will be given to the interested Companies on the 17th October 2017.


The bidding Companies should submit their offers to HAP Centre no later than end of business day on the 10th November 2017.

The offer should include:

1. Letter of interest;
2. The BoQ Excel sheet provided with the tender documents, filled with the respective prices and totals (BoQ template provided in Annex 2);
3. The financial offer in correspondence with the subtotals and total amounts in the BoQ (Format provided in Annex 2);
4. CV of the company (with proves of the experience of the company in carrying out similar works);
5. CVs of directors of the Company;
6. CV of technical team directly responsible for the coordination of the works and to will be deployed to do the work sites (see Annex 4.2 and Annex 4.3);
7. The time table of the works with a brief narrative of the timing and sequence of the jobs to be carried out (see Annex 4, Annex 4.1.1 and Annex 4.1.2);
8. Copy of the registration and license of the company;
9. Copy of its status with the tax authorities and confirmation of Tax Authorities for having No obligations;
10. Document from the bank as a proof of its commercial links and sound finance (within the required limit for such works);
11. For the preparation of the offers, the companies will be obliged to visit the site, verify and make its own measurements; a short report of the visit should be added to the offer.

The application should be sent in sealed envelope no later than end of business day on the 10th November 2017 to the address:

Subject: REHABILITATION OF HEALTH CENTRE OF KURJAN, STRUME, ROSKOVEC IN FIER REGION
Procurement Team
HAP Centre
Rruga "Themistokli Germeji", Pallati Helios, Kati II, Ap.1, Tirana, Albania
E-mail: info@hap.org.al; Website: www.hap.org.al



Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Mbas këtij viti merren të mirëqena pagat respektive

Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi. Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merret shuma e pagave, për të cilat janë paguar kontributet nga data 1.1.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit. Për periudhën e sigurimit në institucione dhe ndërmarrje shtetërore para datës 1.1.1994, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merren pagat referuese të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Për periudhën e sigurimit në ish-kooperativat bujqësore, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merren pagat referuese të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. "Monitor" ka bërë llogaritjen e rasteve konkrete se sa del pensioni i pleqërisë dhe sa për llogaritjen pagat para vitit 1994.

Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi para dhe pas datës 1.1.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës së vlerësuar të periudhave të sigurimit, si ish-punonjësi i institucioneve apo ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-anëtar i kooperativave bujqësore përpara vitit 1994

Si llogaritet pensioni për vitet e punës, para dhe pas vitit '94

Shembujt konkretë dhe tabela me pagat referuese

si dhe e periudhave të sigurimit si person i punësuar, i vetëpunësuar apo ekonomikisht aktiv pas datës 01.01.1994. Për efekt të llogaritjes së pensioneve me datë fillimi pas 1.1.2016 e në vazhdim, baza e vlerësuar mesatare do të llogaritet bazuar në pagat referuese sipas llojit të punës ose funksionit përpara datës 01.01.1994 si edhe mbi pagat individuale mbi të cilat janë paguar kontributet sipas viteve, nga 01.01.1994 deri në 31.12.2015, të indeksuara me indeksin që del nga pjesëtimi i pagës minimale në shkallë vendi të vitit 2015 me pagën minimale të vitit 1994 ose me pagën minimale të vitit përkatës. Koeficientët e indeksimit sipas viteve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Koeficienti i indeksimit para vitit 1994, aktualisht është 8.59.

Për ta konkretizuar këtë problem, po të marrim një

pagë referuese për një specialist të lartë në ndërmarrje ekonomike, që aktualisht është e miratuar në masën 4,192 lekë, duke e shumëzuar me koeficientin 8.59, e indeksuar deri në periudhën aktuale jep një pagë prej 36,009 lekë.

Ndërsa mbas vitit 1994, merren pagat respektive sipas viteve, të cilat duke e shumëzuar me koeficientët përkatës, japin pagën për efekt të llogaritjes së pensionit.

Po të marrim një rast konkret; në vitin 2008, paga minimale ka qenë 14,830 lekë, duke e shumëzuar me koeficientin e indeksimit (i cili miratohet çdo vit me VKM), që është 1.48 jep pagën minimale prej 22000 lekë. Po kështu, edhe paga maksimale, e cila ka qenë 74 150, kur shumëzohet me po këtë koeficient indeksimi, jep pagën maksimale aktuale 97,030.

Sigurisht pagat e ndërmjetme, me indeksimin sipas koeficientëve përkatës, do të na japin paga aktuale ndërmjet minimale e maksimale. Në rast se marrim në mënyrë hipotetike që një punonjësi para vitit 1994 ka

një vjetërsi kontributive prej 15 vitesh dhe paga mesatare e indeksuar rezulton në një shumë prej 25 000 lekë dhe mbas vitit 1994 ka një vjetërsi kontributive prej 22 vitesh, me një pagë mesatare të indeksuar prej

30 000 lekësh, atëherë baza e vlerësuar do të llogaritet: Baza e vlerësuar = $(15 \times 25000 \text{ lekë} + 22 \times 30000 \text{ lekë}) / 37$ (vite gjithsej) = 28 000 lekë Pensioni mujor = $(6750 \times 37 / 35,7) + (1/100 \times 37 \times 28000) = 6996 + 10360 = 17356 \text{ lekë}$.

PAGAT REFERUESE PARA DATES 01.01.1994

Tabela nr 2

Kodi	Nr	Pershkrimi i punes	Paga referuese mujore
Administrata e ndermarjeve			
b1	1	Drejtor	4,932
b2	2	Krveinxhinier, Krveagronom, Krvejeolog, etj te kesaj kategorije	4,713
b3	3	Zv/Drejtor	4,357
b4	4	Krvetar dege, Shef, Pergjegjes reparti	4,220
b5	5	Specialist i larte	4,192
b6	6	Specialist i mesem	3,288
b7	7	Te tjere	2,740
Institucione te tjera lokale			
b8	1	Drejtor, Krvetar Gjykate, Hetuesie, Prokurorie	4,384
b9	2	Zv/Drejtor, Zv/Krvetar Gjykate, Hetuesie, Prokurorie	4,165
b10	3	Specialist i larte	4,110
b11	4	Specialist i mesem	3,507
b12	5	Te tjere	2,740

PAGAT REFERUESE PARA DATES 01.01.1994

Tabela nr 3

Kodi	Nr.	Pershkrimi i punes	Paga Referuese mujore per punetoret
	1	Qymvrguri, bitumi	
c1.1		Nen toke	4,302
c1.2		Siperfaqe	3,491
	2	Miniera te tjera	
c2.1		Nen toke	3,891
c2.2		Siperfaqe	3,293
c3	3	Fabrika te perpunimit te mineraleve	3,293
c4	4	Nafta	3,348
	5	Gjeologjia	
c5.1		Nen toke	3,420
c5.2		Siperfaqe	3,348
c6	6	Metalurgjia me ngjyre	3,304
c7	7	Metalurgjia e zeze	3,392
c8	8	Kimia	3,304
c9	9	Qelqi	3,348
c10	10	Sharrat	3,277
c11	11	Material ndertimi, Tulla, Cimento	3,107
c12	12	Mekanike, Elektrike	2,795
c13	13	Druri, Letra	2,795
c14	14	Lekure, Goma	3,222
c15	15	Tekstil, Trikotazh	2,965
c16	16	Ushqimore	2,707
c17	17	Keputce, Konfeksione	2,795
c18	18	Duhani	2,893
c19	19	Peshkimi	4,110
c20	20	Bujqesi, Pjjet	2,833
c21	21	Blegtori	2,899
c22	22	Tipografia	3,063
c23	23	Tregti, Grumbullim	2,740
c24	24	Ushqim Social	2,466
c25	25	Ndertimi	3,063
c26	26	Mekanizmat e renda	4,110
c27	27	Shofer transporti	3,233
c28	28	Punetori porti	3,420
c29	29	Poste, Telekomunikacion	2,921
c30	30	Mirembajtje truge	2,904
c31	31	Trasporti hekurudhor	3,562
c32	32	Komunale	2,965
c33	33	Punetore te tjere	2,685

PAGAT REFERUESE PARA DATES 01.01.1994

Tabela nr 1

Kodi	Nr	Pershkrimi i punes	Paga referuese mujore
Aparati i Keshillit te Ministrave			
a1	1	Krvetari i Keshillit Ministrave	8,220
a2	2	Zv/Krvetar i Keshillit Ministrave	7,946
a3	3	Kryetar i institucioneve ne vartesi te Keshillit te Ministrave, Sekretar i Peregjithshem, Ndhimesa e Keshilltare, Drejtor	5,480
a4	4	Specialist i larte ne Keshillin e Ministrave	4,932
a5	5	Specialist i mesem	4,110
a6	6	Punonjes te tjere	3,562
a7	7	Sipas kesaj table trajtohen edhe punonjesit e aparatit te ish Komitetit Qendror te PPSH	
Ne Ministri dhe Institucione tjera qendrore			
a8	1	Minister, Krvetar i Akademise se Shkencave	7,672
a9	2	Kryetari i gjykates se Larte, Prokuror i Pergjithshem, Kryetar i Hetuesise se peregjithshme	7,124
a10	3	Zv/Minister, Zv/Kryetar i institucioneve dhe drejtor i drejtorive te peregjithshme ne vartesi te Ministrave	6,302
a11	4	Drejtor drejtorie ne Ministri dhe Institucione Qendrore	5,754
a12	5	Shef sektori ne Institucione Qendrore	5,754
a13	6	Specialist i larte	4,384
a14	7	Specialist i mesem ne ministri	4,000
a15	8	Punetor i kualifikuar	3,288
a16	9	Punetor i thieshte	2,740
a17	10	Sipas kesaj table trajtohen edhe punonjesit e aparatit te keshillave qendrore te organizatave te masave	
a18	11	Sipas kesaj table trajtohen edhe punonjesit e Akademise se Shkencave, punonjesit e aparatit te institucioneve te tjera qendrore dhe te niehuara me	
Ne administraten lokale			
a19	1	Krvetar i Komitetit Ekzekutiv	5,343
a20	2	Enkrvetar, Sekretar	5,042
a21	3	Shef seksioni	4,713
a22	4	Krvespecialist, Pergjegjes zyre	4,384
a23	5	Specialist i larte	4,384
a24	6	Specialist i mesem	3,863
a25	7	Specialiste te tjere	2,740
a26	8	Krvetar i Keshillit, Fshatit te bashkuar	4,658
a27	9	Sekretar i Keshillit, Fshatit te bashkuar	3,836
a28	10	Specialist me arsim te larte ne Keshilla	4,110
a29	11	Specialist i mesem	3,672
a30	12	Sipas kesaj table trajtohen edhe punonjesit e aparatit te komiteve te partise dhe keshillave lokale te organizatave te masave	
a31	13	Te tjere	2,740



AKTIVITET SENSIBILIZUES



Ministrja
Manastirliu: 5
mamografë të rinj
në spitalet rajonale

KËSHILLA



11 mënyra të
thjeshta për
parandalimin e
kancerit

Ylli Merja:



◆ Mjeku
popullor:
Shkaku
kryesor,
pakujdesia
në kurimin e
bajameve

Mënyrat për të kurrar artritit brenda një jave

"Edhe fëmijët mund të
preken nga kjo sëmundje"

• Konsumoni karota për uljen e kolesterolit dhe sulmeve kardiake

Mjeku popullor: Shkaku kryesor, pakujdesia në kurimin e bajameve

Ylli Merja:

Mënyrat për të kuruar artritin brenda një jave

"Edhe fëmijët mund të preken nga kjo sëmundje"

Voltiza Duro

Artriti është një problem që zakonisht shfaqet me kalimin e moshës, por me raste mund të prekë edhe fëmijët. Mjeku popullor Ylli Merja, në një intervistë të dhënë për suplementin "Life Pages" të "Gazeta Shqiptare" tregon format më të shpeshta të kësaj sëmundjeje, simptomat e para, diagnostikimin dhe mënyrat e trajtimit të tij nëpërmjet fuqisë së kurave popullore.

Çfarë është artriti?

Të gjitha sëmundjet si artriti reumatoid, borsiti, menisqet, problemet e dhimbjeve lumbarë, hernia diskale, pak a shumë kanë të njëjtën natyrë. Në thelb ato janë veçse një infeksion alergjik që prek membranat sinoviale. Këto membrana janë si qese që mbajnë lëngun sinovial, dhe ky i fundit ndodhet midis kockave dhe kyçeve e nuk i lejon ato që të fërkohen e të konsumojnë njëra-tjetrën. Ky inflamacion alergjik që ndodh në kyçe prek mosha nga më të ndryshmet, duke filluar që nga moshat 20-30 vjeçe. Fillimisht këto baktere qëndrojnë në gjendje pasive, por bëhen aktive në momentin që depozitohen në palcën e kuqe të kockave dhe nëpër kyçe e shkaktojnë dhimbje.

Cilat janë disa nga format e tij?

Format më të njohura janë disa, ku mund të përmend Shafarad Stilid, i cili shfaqet në moshat 3-7 vjeçare, si pasojë e një sëmundjeje të shpeshtë në bajame apo veshka. Këto dhimbje bëhen aq të bezdisshme, sa fëmijët mund të arrijnë në atë pikë sa nuk lëvizin dot. Një tjetër formë është artriti kronik, që përparon në mënyrë progresive në trupin e njeriut dhe dhimbja vjen duke u përshkallëzuar. Ndërsa, poliartiriti është një lloj tjetër i artritit, që fillon të lëvizë në pjesë të ndryshme të



trupit, pra quhet ndryshe edhe artriti "shëtitës", ku dhimbja në momente të ndryshme, lokalizohet në pjesë të ndryshme. Ka dhe forma të tjera, si gonoartroza, e cila ndodh kur në pjesën e kupave të gjunjëve

lëngu sinovial fillon të thahet, dhe këtu depozitohen stafilokokë. Në rastet kur pacienti ka mungesë të theksuar lëngjesh, kjo shpeshherë, shoqërohet edhe me kërcitje të kockave. Një formë tjetër është dhe artriti urik, i cili lidhet drejtpërdrejt me sasinë e lartë të acidit urik në organizëm.

Çfarë mund ta shkaktojë këtë sëmundje?

Në rastet kur tregoheni të pakujdesshëm në kurimin e ba-



jameve, gjëndrat limfatike fillojnë të acarohen dhe prodhojnë limfocitet T, të cilat shumohen në numër dhe trupi prodhon antikorpusë kundër faktorit reumatoid që është shumë. Këta stafilokokë që zhvendosen nga bajamet, shkojnë në veshka, e më tej hyjnë në qarkullimin e gjakut. Nëse një trup nuk funksionon në mënyrë të sinkronizuar, duke përfshirë këtu gjëndrat endokrine dhe organet e tjera, është më i predispozuar për t'u prekur nga këta ngacmues të jas-



Mjeku popullor Ylli Merja

htëm, ku përfshihen edhe këto baktere që shkaktojnë sëmundjen e artritit.

Cilat janë simptomat e para?

Me kalimin e kohës fillojnë shqetësimet e para, që shoqërohen me ndjesi këputjeje, lodhjeje, temperaturë, dhimbje gjunjësh e kockash si dhe me mungesë oreksi. Këto shenja shfaqen kur stafilokokët hyjnë në gjak e fillojnë të bëhen aktivë, të shumohen dhe të përhapen në trup. Stadi i dytë i kësaj sëmundjeje progresive është që, nëse nuk kurohet, ai përparon në mënyrë të përshkallë-

tejnë C reaktive dhe acidin urik. Në momentin që acidi urik rezulton i lartë, atëherë pacienti edhe depozitime të larta të kalciumit në kocka, çka shkakton deformimin e kockave, që shfaqet më tepër në gishtat e këmbës dhe të dorës.

Si keni arritur ta kuroni nëpërmjet metodës popullore këtë sëmundje?

Duke njohur shumë mirë vetitë kuruese të disa bimëve, ne filluam t'i testonim ato që para 10 vitesh dhe morëm rezultate tepër pozitive. Ne e dimë që artriti dëmton edhe zëmërin, kështu që në kompozimet e çajit kurues shtuam edhe bimë që mbrojnë zëmërin. Nuk përdorim vetëm një bimë, por duke ditur vetitë e përafërta të bimëve mjekësore, kemi kompozuar këtë çaj, që redukton acidin urik të ngritur, i cili jep edhe probleme në veshka, si dhe të sjellë një funksionim të mirë të qarkullimit të gjakut në arterie dhe vena. Aty ku gjaku qarkullon lirshëm, shkon edhe lëndët ushqyese dhe oksigjeni.

Si mund të kurohet artriti?

Pacientët duhet të pinë një gotë çaj që ne e përgatisim me bimë mjekësore në çdo vakt. Ne në kompozimin e këtij çaji futëm bimë që të mbrojnë edhe zëmërin. Lëvrija e shelgut është një tjetër trajtim që përdorim për pacientët, pasi hollon gjakun. Edhe vajji i sinapit është një preparat shumë i mirë, që nxit qarkullimin e gjakut dhe ndihmon në kurimin e artritit.

Pas sa kohësh mund të shohin efekte pozitive pacientët?

Zgjidhja e problemit të artritit reumatoid është e dukshme brenda një periudhe kohe shumë të shkurtër, pra brenda një jave.

zuar. Gjatë këtij momenti kemi përhapje simetrike në të dyja gjymtyrët, dhe fillon të japë dhimbje, dobëson enët e qarkullimit të gjakut dhe i hollon. Këto të fundit, me ndryshimin e shtypjes atmosferike bëhen të brishta dhe ulja e shtypjes shkakton çarjen e kapilarëve, çka jep shumë dhimbje te pacienti.

Si diagnostikohet artriti?

Një pacient i cili verifikon se ka disa nga simptomat e sipërpërmendura, mund të kryejë disa diagnostikime, si faktori reumatoid, fibrinogjenin, pro-

Aktivitete sensibilizues kundër kancerit të gjirit në Pazarin e Ri

Në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit, ditën e djeshme në Pazarin e Ri në kryeqytet, u zhvillua një aktivitet sensibilizues. Pjesë e këtij event-i ishte edhe ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, e cila u bëri thirrje grave që të bëjnë një diagnostikim të hershëm për kancerin e gjirit. "Jemi këtu sot për të apeluar për kryerjen e ekzaminimit të gjirit, pasi diagnostikimi i hershëm i këtij tumori të shpëton jetën. Ne si Ministri e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të fuqizojmë spitalet rajonale me 5 mamografë të rinj, përkatësisht në Vlorë, Durrës, Kukës, Dibër e Lezhë. Ndërkohë, mamografët e lëvizshëm do të vijojnë rrugëtimin e tyre përgjatë gjithë vitit, për të kryer këtë depistim edhe në zonat rurale, ku ka mungesë aksesit për këtë shërbim", - tha ministria. Gjatë aktivitetit kanë qenë të pranishme edhe gra të cilat kanë fituar ndaj betejës me kancerin. "Donika ia ka dalë ta mundë sëmundjen. Ia ka dalë sepse ka arritur të diagnostikohet në kohë. Po ashtu edhe dr. Oltiana. Ajo është njëherësh mjekë dhe paciente. Këto gra të forta me historitë e tyre frymëzuese janë shembulli më i mirë i rëndësisë që ka diagnostikimi i hershëm. Në këtë muaj ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit, nuk do të reshim së thëni e ngulituri fort në mendjen e çdo gruaje, se kanceri i gjirit është një kërcënim real për secilën prej nesh. Por beteja me kancerin e gjirit është një betejë që mund të fitohet! Siç e ka fituar Donika, Oltiana e shumë gra që ia kanë dalë ta mundin sëmundjen", - u shpreh Manastirliu. Gratë treguan historitë personale të luftës me këtë sëmundje vdekjeprurëse dhe falënderuan ministrin për ndihmën që po iu ofron të gjitha grave. "Shumë faleminderit, zonja ministre, për gjithçka që po bëni për ne. Shpresojmë që puna të vazhdojë me këto ritme", - tha njëra prej grave që fitoi betejën me kancerin. Sheshi ku u zhvillua aktiviteti sensibilizues ishte i mbushur me lule rozë, në shenjë ndërgjegjësimi, dhe të gjitha fondet që u grumbulluan do të shkojnë për ndihmë në luftën kundër kancerit të gjirit. Para këtij aktiviteti, Manastirliu u ndal edhe në qytetin e Vlorës, ku po afrohet shërbimi

MINISTRJA MANASTIRLIU: 5 mamografë të rinj në spitalet rajonale



i mamografisë falas për gratë e moshës 40-50 vjeçe, përmes dy mamografëve të lëvizshëm të vënë

në dispozicion nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ku sërish u bëri thirrje grave

që të bëjnë kontrollet përkatëse për ta diagnostikuar në kohë sëmundjen.

“Në këtë muaj ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit, nuk do të reshim së thëni e ngulituri fort në mendjen e çdo gruaje, se kanceri i gjirit është një kërcënim real për secilën prej nesh. Por beteja me kancerin e gjirit është një betejë që mund të fitohet! Siç e ka fituar Donika, Oltiana e shumë gra që ia kanë dalë ta mundin sëmundjen”

HISTORIA E AIDËS NË LUFTËN KUNDËR KANCERIT 47-vjeçarja: Vendosa të mos dorëzohesha

Kur ishte 44 vjeçe, Aida u diagnostikua me kancerin e gjirit, lajm që tronditi botën e saj dhe familjarët. E pyetur nga "Gazeta Shqiptare", 47-vjeçarja tregon betejën më të keqe me të cilën jeta e përballi dhe vullnetin e dëshirën e madhe që pati për ta mposhtur e për të vazhduar para. "Në vitin 2014, gjatë një kontrolli rutinë, mora vesh që isha e prekur nga kanceri i gjirit. Ky lajm më shkatërroi dhe më ra si 'bombë'. Por

më duhej të bëhesha e fortë për veten e për familjen time, kështu që vendosa të mos i dorëzohesha sëmundjes. Fillova të merrja trajtime dhe pas një viti, kur isha 45 vjeçe, bëra operacionin, i cili doli me sukses", - tregon Aida. Pas operacionit, ajo vazhdoi trajtimet me kimioterapi dhe tashmë pas 3 vitesh, falënderon të gjithë ata që i qëndruan afër në ato momente të vështira.



11 mënyra të thjeshta për parandalimin e kancerit

Qelizat kancerogjene nuk zhvillohen brenda natës. Ka shumë mënyra për ta parandaluar dhe luftuar kancerin, ku përfshihen forma e të ushqyerit dhe aktiviteti gjatë jetës së përditshme. Natyrisht, duhet të kryhen konsulta gjithmonë me mjekun për çfarëdo lloj shqetësimi që mund të keni. Më poshtë po japim disa këshilla për të reduktuar risikun e zhvillimit të qelizave kancerogjene në trupin tuaj.

Eliminoni pijet me sheqer

Jo vetëm që pijet me sheqer ndikojnë në shëndoshje dhe diabet, por ato gjithashtu mund të rrisin rrezikun e kancerit të endometrialit. Sipas hulumtimit nga Shkolla e Shëndetit Publik të Universitetit të Minesotës, te gratë që pinin sasi të mëdha të pijeve të mbushura me sheqer, rreziku për t'u prekur nga kanceri ishte deri në 87% më i lartë.

Lëvizni më shumë, uluni më pak

Studime të reja sugjerojnë se njerëzit që e kalojnë shumicën e ditës të ulur janë në një rrezik 24% më të lartë për kancerin e zorrës së trashë dhe të endometrit sesa njerëzit që shpenzojnë më pak kohë në karrige. Hulumtime të tjera treguan se njerëzit që kaluan më shumë kohë para TV kishin 54% rritje të rrezikut të kancerit të zorrës së trashë sesa ata që panë më pak TV. Duhet të ngrihen dhe të ecni të paktën një herë në orë.

Konsumoni sa më shumë brokoll

Brokoli është një ushqim super-parandalues i kancerit, prandaj duhet ta konsumoni shpesh. Por përpiquni që të mos e hani të skuqur apo të zier sepse humbasin komponentët e shëndetshëm që përmban.



Hani hudhër

Hudhra përmban komponentë që mund të stimulojnë mbrojtjet natyrore të sistemit imunitar kundër kancerit dhe mund të ketë potencial për të ndihmuar trupin të heqin qafe kemikalet që shkaktojnë kancer dhe të ndihmojnë që qelizat e kancerit të vdesin natyrisht, një proces i quajtur apoptoza. Studimi i Shëndetit të Gruas Iowa tregoi se gratë që konsumonin sasinë më të lartë të hudhrave, kishin një rrezik 50% më të ulët të kancerit të zorrës së trashë krahasuar me gratë që hëngrën më pak.

Pini çaj jeshill

Më shumë se 50 studime mbi lidhjen midis rrezikut të çajit dhe kancerit janë botuar që nga viti 2006, sipas Institutit Kombëtar të Kancerit. Fuqitë shëruese të çajit të gjelbër janë vlerësuar në Azi për mijëra vjet. Disa shkencëtarë besojnë se një element kimik në çajin jeshill, EGCG, mund të jetë një nga përbërësit më të fuqishëm kundër kancerit të zbuluar ndonjëherë për shkak të numrit të lartë të antioksidantëve.

Marinojeni mishin që konsumoni

Temperatura e lartë e kërkuar për të ngrënë mish krijon komponime të quajtura amina heterociklike që janë të lidhura me kancerin. Këto komponime mund të dëmtojnë ADN-në e mjaftueshme për të nxitur rritjen e tumoreve në zorrën e trashë, gjirit, prostatës dhe qelizat limfatike. Një studim i Universitetit

të Minesotës zbuloi se ngrënia e mishit të djegur rregullisht mund të rrisë rrezikun e kancerit të pankreasit deri në 60%. Sipas hulumtimit në "Journal of Agriculture and Food Chemistry", marini i mishit të kuq në birrë ose verë për dy orë para gatimit reduktoi sasinë e këtyre përbërjeve të dëmshme. Hulumtimi i Universitetit Shtetëror të Kansasit zbuloi se fërkimi i rozmarinës në mish të papjekur bllokoi formimin e këtyre komponimeve që shkaktojnë kancerin deri në 100%.

Pini qumësht

Studimet kanë treguar se kaliumi

Megjithëse 700 mg mund të tingëllojë si shumë, mund të shtohet me një filxhan kos të ulët yndyre për mëngjes (345 mg), një filxhan me qumësht me yndyrë të ulët me drekë (300 mg) dhe një filxhan spinaq në sallatë me darkë (292 mg).

Hani më pak proteina shtazore me yndyrë të lartë

Pas ndjekjes së regjimit ushqimor të më shumë se 121,000 të rriturve deri në 28 vjeç, hulumtuesit e Harvardit zbuluan se njerëzit që hanin tre porcione mish të kuq çdo ditë kishin rreth 13% më shumë gjasa të vdisnin; shpesh nga sëmundjet e zemrës ose kanceri.



të mbrojtje nga kanceri i zorrës së trashë. Pjesëmarrësit në Studimin e Shëndetit të Infermierëve që konsumonin më shumë se 700 mg kalium në ditë në ditë kishin deri në 45% rrezik të zvogëluar të kancerit të zorrës së trashë sesa ata që konsumonin 500 mg ose më pak në ditë.

Kështu që, për ta parandaluar risikun duhet të pini qumësht me yndyrë të ulët, të përzgjidhni më tepër konsumin e mishit të shpendëve dhe peshkut, në vend të mishit të derrit apo vicit. Gjithashtu, është më mirë për shëndetin tuaj që në vend të gjalpit të përdorni vajin e ullirit.

Hani salmon të egër

Sipas studimeve, gratë që hanin peshk tri herë në javë ose më shumë, kishin 33% më pak të ngjarë të pësonin rritje të indeve në zorrën e trashë që mund të shndërrohen në kancer. Peshku, sidomos salmoni, është i pasur me acide yndyrore anti-inflamatore omega-3, të cilat janë përgjegjëse për efektet e luftimit të kancerit. Studiuesit australianë zbuluan se njerëzit që hëngrën katër ose më shumë vakte peshku në javë ishin më pak të riskuar për të zhvilluar leukeminë e gjakut.

Hani qepë

Hulumtuesit e shkencës së ushqimit në Cornell zbuluan se qepët kanë vetitë e fuqishme antioksiduese, si dhe komponimet që pengojnë rritjen e qelizave kancerogjene.

Mundohuni të ecni 30 minuta në ditë

Për më tepër se dy dekada, studimet kanë treguar se gratë që ushtrojnë një aktivitet të caktuar fizik kanë një rrezik 30-40% për t'u prekur nga kanceri i gjirit sesa gratë më pak aktive. Stërvitja e moderuar ul nivelin e estrogenit të gjakut, një hormon që mund të ndikojë në rrezikun e kancerit të gjirit. Një studim tjetër thotë se me katër orë në javë ecje, mund të reduktohet rreziku i kancerit të pankreasit deri në 50%. Përfitimet janë të lidhura me përmirësimin e metabolizmit të insulinës për shkak të stërvitjes.

Merrni 15 minuta rreze dielli

Pothuajse 90% e vitaminës D në trupin tuaj vjen direkt nga rrezet e diellit, jo nga ushqimi ose shtesat. Studimet kanë treguar se një mangësi e vitaminës D mund të zvogëlojë komunikimin mes qelizave, duke shkaktuar që ata të ndalojnë të qëndrojnë së bashku dhe të lejojnë që qelizat e kancerit të përhapen. Vitamina D mund të ndihmojë në nxirjen e maturimit dhe riprodhimit të duhur të qelizave. Njerëzit me nivele të ulëta të vitaminës D kanë një rrezik më të lartë të kancerit të shumëfishtë, duke përfshirë gjoksin, zorrën e trashë, prostatën, stomakun, si dhe osteoporozën, diabetin, sklerozën e shumëfishtë dhe presionin e lartë të gjakut. Por shmangni orët e shumta në diell, të cilat mund të shkaktojnë kancerin e lëkurës, pasi ju duhen vetëm disa minuta në ditë për të prodhuar nivele adekuate të vitaminës D.

Këshilla

Konsumoni karota për uljen e kolesterolit dhe sulmeve kardiake

Përfitimet shëndetësore të karotës përfshijnë uljen e kolesterolit, rrezikun më të ulët të sulmeve në zemër, parandalimin e kancerit dhe uljen e shenjave të plakjes së parakohshme. Për më tepër, karotat kanë aftësinë të përmirësojnë shëndetin e lëkurës tuaj, forcojnë sistemin imunitar, përmirësojnë tretjen, shëndetin kardiovaskular në mënyra të ndryshme. Ato, gjithashtu, sigurojnë një fluks të pasur të vitaminave dhe mineraleve. Karota është një nga perimet më të përdorura dhe më të shjuara në botë, pjesërisht për shkak se ato rriten relativisht lehtë. Pjesa më e madhe e përfitimit të karotave mund t'i atribuohet përmbajtjes së tyre të beta-karotenit dhe fibrave. Kjo perime rrënjore është, gjithashtu, një burim i mirë i agjentëve antioksidues. Për më tepër, ato janë të pasura me vitaminë A, C, K dhe B8, si dhe acid pantotik, folatë, kalium, hekur, bakër dhe mangan. Kolesterolit i lartë është një faktor kryesor për sëmundjet e zemrës. Meqenëse konsumi i rregullt i karotës redukton nivelin e kolesterolit, është një ide e mirë të konsumoni një dozë të shëndetshme karote, me qëllim parandalimin e problemeve të zemrës. Një grup shkencëtarësh suedezë zbuluan se këto perime rrënjore mund të ulin shanset për të pasur një sulm në zemër. Karotat janë burime të pasura të kaliumit dhe mund të lehtësojnë tensionin në enët e gjakut e në arterie, duke rritur qarkullimin dhe funksionin e organit në të gjithë trupin e duke ulur stresin në sistemin kardiovaskular. Tensioni i lartë i gjakut është, gjith-



ashtu, i lidhur drejtpërdrejt me arteriosklerozën, goditjet dhe sulmet në zemër, kështu që ky është edhe një aspekt tjetër i shëndetshëm i karotave. Karota përmban një numër të elementeve antiseptikë dhe antibakterialë që i bëjnë ato ideale për rritjen e sistemit imunitar. Jo



vetëm kaq, ato janë një burim i pasur i vitaminës C, që stimulon aktivitetin e qelizave të bardha të gjakut dhe është një nga elementët më të rëndësishëm në sistemin imunitar të njeriut. Karotat, gjithashtu rregullojnë sasinë e insulinës e glukozës, që përdoret dhe metabolizohet nga trupi, duke siguruar një luhatje më të barabartë dhe të shëndetshme për pacientët diabetikë. Vlen të theksohet se konsumi

Beta-carotene ka qenë i lidhur me një rrezik të reduktuar të disa kancerëve, sidomos kancerit të mushkërive. Studiuesit britanikë zbuluan se rritja e konsumit të beta-karotenit nga 1.7 në 2.7 miligram në ditë redukton

rrezikun e kancerit të mushkërive me më shumë se 40%. Karota mesatare përmban rreth tre miligramë beta-karotene. Në një studim të veçantë, u zbulua se karotat, të pasura me fibra zvogëlojnë rrezikun e kancerit të zorrës së trashë deri në 24%. Një hulumtim tjetër tregon se gratë që hanin karota të papërpunuara kishin 5-8 herë më pak gjasa për t'u prekur nga kanceri i gjirit.



RREPA E KUQE Ja vetitë kuruese të saj

Rrepa është një perime tipike sezonale, e cila nëse nuk prodhohet në serra, ndryshe nga perimet e tjera, do të jetë në treg për një periudhë relativisht të shkurtër kohe. Kjo do të thotë se ekziston mundësia që rrepat të gjenden në treg gjatë tërë vitit. Hulumtimi i kryer vite më parë, ka treguar se përbërësit e rrepës luftojnë sëmundjet e lidhura me kujtesën. Kjo bimë, e cila preferohet të përfshihet në dietën e përditshme qoftë në formë sallate, lëngu ose në gjellë, po ashtu është e mirë për rregullimin e sistemit tretës. Përbërësit që përmban kjo perime, ngadalësojnë zhvillimin e tumorit në prostatë dhe gji me 12,5%. Rrepa e kuqe është shumë e pasur në



fibra, të cilat ofrojnë ndjesinë e ngopjes që do të zgjasë. Gjithashtu, konsumimi i saj, përshpejton metabolizmin, duke stimuluar dhe përmirësuar procesin e tretjes, që do t'ju ndihmojë për të humbur peshën e tepërt. Ajo është edhe një burim i madh i vitaminës C e kështu forcon sistemin imunitar, dhe ngadalëson procesin e plakjes. Rrepa, gjithashtu, posedon një bollëk mineralelesh, kalcium, por është e pasur edhe me bakër, hekur, krom, mangan dhe nikel. Rrepa e kuqe ndikon në sistemin kardiovaskular shumë pozitivisht dhe është në gjendje të zvogëlojë nivelin e kolesterolit të keq në gjak. Përdërisa mund të stabilizojë nivelin e sheqerit në gjak, rrepa rekomandohet në rast se vuani nga hipoglicemia ose diabeti. Duke konsumuar rregullisht rrepa do të jeni në gjendje të zvogëloni rrezikun e shfaqjes së gurëve në veshkave dhe falë kalciumit, do të ulni dhe do të normalizoni presionin e lartë të gjakut. Rrepa ndihmon edhe kur është fjala për parandalimin e shfaqjes të kancerit të zorrës së trashë e ndikon pozitivisht në shëndetin e përgjithshëm të kockave, të dhëmbëve dhe të mishrave.

Lista emërore në Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë. Kompensimi fizik e financiar, në rend kronologjik

ATP, statusi i secilës pronë në Shkodër

Emrat e pronarëve, sipërfaqja e pretenduar dhe sa kompensohet

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtitimit të Pronës ka përditësuar regjistrin e saj elektronik për dosjet e pronave në të gjithë vendin. Çdo trashëgimtar pronash ka mundësi të lexojë në "Gazetën Shqiptare" statusin e dosjes së tij dhe problematikën e dokumenteve që mund të ketë secili pronar. Regjistri elektronik mban të

dhëna të detajuara për çdo aplikim dhe çdo proces që ka ndodhur me pronat që nga viti 1993 dhe deri tani për qarkun e Shkodër. Secila nga dosjet përmban emrin e subjektit të shpronësuar si dhe emrin e subjekteve që e pretendojnë atë pronë. Në dosje pasqyrohen sipërfaqja e pretenduar si dhe lloji i pasurisë, sipërfaqja e njohur, sipërfaqja e kthyer apo e kompensuar. Ndërkohë që pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e Komisioneve dhe Zyrave Rajo-

nale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për secilin subjekt, bashkë me vendimet gjyqësore dhe problematikën e secilës dosje. "Gazeta Shqiptare" nis sot publikimin e listës së veprimeve që janë kryer me dosjet e pronave të qarkut të Shkodër. Të gjithë të interesuarit njihen gjithashtu edhe me problematikën që mund të ketë dosja e tyre, siç është mungesa e dokumenteve të caktuara. Ndërkohë, Agjencia e Tra-

jtimit të Pronave ka marrë në shqyrtim dosjet në qarkun e Elbasanit, të cilat janë në proces shqyrtimi. Regjistri i dosjeve në shqyrtim pasqyron numrin e dosjes, emrin e subjektit të shpronësuar, kërkesin, llojin e pasurisë si dhe të dhënat në lidhje me sipërfaqen e njohur, sipërfaqen e kthyer dhe sipërfaqen e kompensuar. Në regjister janë edhe të dhënat për çdo dosje për vendimet e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe prob-

lematika që ka çdo dosje, e cila pasqyron mangësinë në dokumentacion. Sot publikohet regjistri elektronik i pronave në qarkun e Shkodrës, ku përfshihen Shkodra, Malësia e Madhe dhe Puka. Dosjet ndodhen në Agjencinë e Trajtitimit të Pronave në proces shqyrtimi dhe do të trajtohen me ligjin e ri. Vendimi do të merret sipas rendit kronologjik të kërkesave dhe kompensimi do të shpërndahet sipas këtij rendi, me përjashtim të rasteve

kur subjekti kërkon të përfillojë nga pagesa e përshpejtuar, ose kërkon të jetë pjesë e tenderit për kompensimin fizik në bazë të pronave që ka vënë në dispozicion ATP-jë. ATP-ja do t'i japë përparësi kompensimit të trullit. Kompensimi për ish-pronarët për tokën trull, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe vendimi do të merret sipas rendit kronologjik të kërkesave dhe kompensimi do të shpërndahet sipas këtij rendi, me përjashtim të rasteve

LISTA E VEPRIMEVE QË JANË KRYER ME DOSJET E PRONAVE TË QARKUT TË SHKODRËS (PJESA E DYMËDËHJETË)

(Vijon nga numri i djeshëm)

Emri (Subjekti i shpronësuar)	Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri (Subjekti Kërkuar)	Mbiemri (Subjekti Kërkuar)	Sip. E pretenduar, m2 & lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	NR I Vendimit I KKKP, ZRKKP	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika
Fahri	Kali	Fahri	Kali			83	Vendim negativ per mungese te dokumentacionit		Ka Vertetim pronesie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Cile	Tukja	Cile	Tukja			82	Vendim negativ per mungese te dokumentacionit		Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Julita	Gjeloshi	Julita	Gjeloshi	Sip. E papercaktuar		81	Vendim negativ per mungese te dokumentacionit		Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Elena	Krajni	Elena	Krajni	Sip. E papercaktuar		80	Vendim negativ per mungese te dokumentacionit		Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Kol	Pellumbi	Kol	Pellumbi	Sip. E papercaktuar		79	Vendim negativ per mungese te dokumentacionit		Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Esat	Mani	Esat	Mani	Sip. E papercaktuar		78	Vendim negativ per mungese te dokumentacionit		Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Xhemal, Ferid, Sebij dhe Zyhra	Kraja	Trashigimtarët		966m2 trull		77	966		Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Albert	Akshija(Kadarja)	Albert	Akshija(Kadarja)	Sip. E papercaktuar		76	Vendim negativ per mungese te dokumentacionit		Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Maliq	Baci	Maliq	Baci	Sip. E papercaktuar		75	Vendim negativ per mungese te dokumentacionit		Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Fatmir	Derxhini	Fatmir	Derxhini	Sip. E papercaktuar		74	Vendim negativ per mungese te dokumentacionit		Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Maliq	Haxhagjiq	Maliq	Haxhagjiq	Sip. E papercaktuar		73	Vendim negativ per mungese te dokumentacionit		Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Ahmet	Islami	Ahmet	Islami	1475m2 trull		70	Vendim negativ per mungese te dokumentacionit		Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Fehmi	Quku	Fehmi	Quku	Sip. E papercaktuar		71	Vendim negativ per mungese te dokumentacionit		Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Hatije	Vorfa	Hatije	Vorfa	Sip. E papercaktuar		72	Vendim negativ per mungese te dokumentacionit		Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua

Myrije	Pacrami	Berhan	Pacrami	1520m2 truall	Shkoder	10	1330	840	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Sulejman	Dani	Sulejman	Dani(Tras higimtare)	480m2 truall	SHkoder	11	480	320	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Abdyl	Brahimi	Hysni	Brahimi	1280 m2 truall		12	1280		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Zenel	Sterniqi	Ramadan	Sterniqi	5310m2 truall		13	5204		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Caf	Nehani	Caf	Nehani(Tras higimtare)	2380m2 truall	Bahcallek Shkoder	14	2380		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Muhamet	Lika	Muhamet	Lika(Tras higimtare)	Sip. E papercaktuar	8592	263	782.5		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Lutfije	Lopci	Shuajp	Lopci	Sip. E papercaktuar		1065	2299	1500	Ka Vertetim pronesie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Haxhi	Omari	Lejla	Omari	Sip. E papercaktuar		265			Ka Vertetim pronesie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua Vendim negativ per mungese dokumentacioni
Daut	Kopliku	Menduh	Kopliku	Sip. E papercaktuar		266			Ka Vertetim pronesie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua Vendim negativ per mungese dokumentacioni
Nush	Daberdaku	Ndrek	Daberdaku	Sip. E papercaktuar		267			Ka Vertetim pronesie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua Vendim negativ per mungese dokumentacioni
Sait,Hyse n,Taip dhe Ramadan	Tafili	Qemal	Tafili	Sip. E papercaktuar		268			Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua Vendim negativ per mungese dokumentacioni
Brahim	Hysa	Elez	Merdasti	Sip. E papercaktuar	8597	269	12200		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Sul	Kruja	Admir	Kruja	Sip. E papercaktuar		250			Ka Vertetim pronesie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua Vendim negativ per mungese dokumentacioni
Sul	Begu	Fehmi	Barbullushi	Sip. E papercaktuar		251			Ka Vertetim pronesie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua Vendim negativ per mungese dokumentacioni

Ymer	Lutfija	Njazi	Lutfija	Sip. E papercaktuar		252			Vendim negativ per mungese dokumentacioni	Ka Vertetim pronesie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Eljaz	Muka	Eljaz	Muka(Tras shigimtare)	Sip. E papercaktuar		253			Vendim negativ per mungese dokumentacioni	Ka Vertetim pronesie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Kol	Bazhdari	Cesk	Bazhdari	Sip. E papercaktuar		254			Vendim negativ per mungese dokumentacioni	Ka Vertetim pronesie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Maliq	Bekteshi	Nura	Bekteshi	Sip. E papercaktuar		255			Vendim negativ per mungese dokumentacioni	Ka Vertetim pronesie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Dulo	Kali	Xhelal	Kali	Sip. E papercaktuar		256			Vendim negativ per mungese dokumentacioni	Ka Vertetim pronesie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Qamil	Rustemi	Qamil	Rustemi(Tras higimtare)	Sip. E papercaktuar		257			Vendim negativ per mungese dokumentacioni	Ka dokum.ar kivor Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Elez	Jubica	Ahmet	Jubica	Sip. E papercaktuar		258			Vendim negativ per mungese dokumentacioni	Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Kasem	Katica	Nurije	Katica	Sip. E papercaktuar		259			Vendim negativ per mungese dokumentacioni	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Nuh	Kruja	Belkize	Kruja	Sip. E papercaktuar		260			Vendim negativ per mungese dokumentacioni	Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Sadik ; Musa	Lacja	Ali ; Sami	Lacja	Sip. E papercaktuar		261			Vendim negativ per mungese dokumentacioni	Ka Vertetim pronesie Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Hasan ; Haxhi ; Sulejman	(Hoti)	Ferit	Ulqinaku	Sip. E papercaktuar		262	35	35		Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Salih	Ulqinaku	Berhan	Ulqinaku	Sip. E papercaktuar		242			Vendim negativ per mungese dokumentacioni	Ka VFJ Nuk ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Jakup	Vasija	Zyhdi	Vasija	Sip. E papercaktuar		241			Vendim negativ per mungese dokumentacioni	Ka Vertetim pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua

(Vijon nesër)

Katowica

Presidenti "rus" i Republikës Çeke

(Vijon nga faqja e parë)

Nga SHABAN MURATI

Çekia e ka provuar agresionin direkt rus në vitin 1968, por presidenti çek e ka harruar atë agresion.

... integrojnë veten në identitetin dhe në familjen europiane. Tipik është në këtë drejtim Presidenti i Republikës Çeke, Millosh Zeman, i cili edhe 13 vjet pas anëtarësimit të shtetit të vet në BE dhe në NATO, jo vetëm nuk është identifikuar me profilin dhe me interesin europian, por në postin e kryetarit të shtetit sillet sikur Çekosllovakia është akoma anëtare e Traktatit të Varshavës, të udhëhequr nga Moskë, gjë që ka shtyrë shumë diplomatë ta quajnë atë "presidenti rus i Republikës Çeke". Për ta rikonfirmuar profilin e tij rus, presidenti Zeman bëri në 10 tetor në Asambledhë Parlamentare të Këshillit të Europës një propozim, i cili i detyroi shumë delegatë të vendeve anëtare të pyesnin veten nëse kishin përpas tyre duke folur një të deleguar të Kremllit. Presidenti i Çekisë e shpalli "një çështje të mbyllur" Krimenë e pushtuar dhe të aneksuar nga Rusia në vitin 2014. Për ta sanksionuar këtë, ai doli me propozimin origjinal që çështja tani të zgjidhet duke i paguar Rusia disa kompensime Ukrainës në formë financiare ose në formën e furnizimit me gaz dhe naftë.

Ishte një skandal diplomatik i paparë, një kundërvënje e hapur ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të Ukrainës dhe një mbrojtje e agresionit rus në Ukrainë. Ishte një kundërvënje e hapur ndaj qëndrimeve dhe vendimeve të BE-së dhe të NATO-s për klasifikimin e ndërhyrjes ruse si një agresion, për shkak të të cilit BE-ja vendosi qysh në 2014-ën sanksionet kundër Rusisë, të cilat vazhdojnë edhe sot e kësaj dite. Zeman përsëriti në Asambledhë Parlamentare të Këshillit të Europës kërkesën e tij për heqjen e sanksioneve ndaj Rusisë. Presidenti çek e veçoi veten nga BE dhe nga NATO, ku Republika Çeke është anëtare, por ai e veçoi edhe nga Asambleja e Përgjithshme e OKB, e cila e ka cilësuar të paligjshëm aneksimin dhe pushtimin e Krimesë nga Rusia.

Qëndrimi i Zemanit për ta kompensuar aneksimin e Krimesë me para nga Rusia, shkaktoi një stuhë zemërimi në Ukrainë, ku propozimin e presidentit çek e cilësuan "shitje e Krimesë dhe e Ukrainës", sepse ai e reduktonte të drejtën juridike të kthimit të Krimesë nën sovranitetin e Ukrainës si çështje kompensimi financiar. Nën kryetarja e Radës së Lartë të Ukrainës, Irina Gershaçenko brenda ditës iu përgjigj presidentit çek me deklaratën: "Është e trishtueshme të shohësh degradimin e plotë politik. Kemi një shpërbërje të paprincipialitetit dhe një mungesë morale dhe parimesh". Anëtar i delegacionit të Ukrainës në Asambledhë Parlamentare të Këshillit të Europës, Borislav Berez, i kujtoi presidentit çek se në 1-10 tetor 1938, një pjesë e Çekosllovakisë u pushtua nga Hitleri në të njëjtën mënyrë si Krimea nga Rusia, dhe i drejtoi pyetjen: "A do të ishte dakord ai nëse Hitleri do t'i propozonte kompensim për Sudetët e aneksuara?"

Ka q flagrant ishte qëndrimi prorus i presidentit Zeman për Ukrainën dhe ai në pozitë të vështirë ndërkombëtare e vuri shtetin e vet, sa që, megjithëse ai foli në postin zyrtar të kryetarit të shtetit dhe i bëri deklaratat në një forum të lartë diplomatik dhe parlamentar ndërkombëtar, Ambasada e Republikës Çeke në Ukrainë në një reagim të saj në 10 tetor i klasifikoi deklaratat e presidentit si mendime personale.

Entuziazmi i presidentit çek për mbrojtjen e interesave ruse shtrihet në shumë çështje të politikës së jashtme çeke. Në këtë linjë ai disa herë u është



kundërvënë qëndrimeve të drejta të qeverisë çeke, që ka njohur shtetin e pavarur të Kosovës. Në datën 6 tetor, presidenti Zeman doli kundër pavarësisë së Kosovës dhe kundër njohjes së saj nga Republika Çeke. Në një qëndrim aspak serioz për një kryetar të shtetit, që e ka njohur Kosovën, Zeman u mburr se ai ka refuzuar të caktojë një ambasador të Çekisë në Prishtinë dhe nuk do të lejojë një përfaqësi të Kosovës në Pragë. Kushdo që njihet sadopak normat që rregullojnë marrëdhëniet midis shteteve, e ka vështirë të

kuptojë logjikën e një kryetari shteti, i cili del kundër shkëmbimit të ambasadorëve me shtetin, me të cilin shteti i tij ka vendosur marrëdhënie diplomatike. Për freskim kujtese po i përmendim lexuesit se presidenti Zeman ka qenë edhe kundër bombardimeve ajrore të NATO-s ndaj Serbisë në vitin 1999.

Zeman përsëriti tezat e diplomacisë ruse, duke kërkuar ta përligjë aneksimin rus të Krimesë me mbështetjen e Perëndimit për pavarësimin e Kosovës. Ai kritikoi Perëndimin se janë aplikuar dy stan-

darde, njëri për Krimenë dhe tjetri për Kosovën, edhe pse shumica e vendeve të BE-së dhe të NATO-s kanë njohur Kosovën. Spekulumi diplomatik i ngjashmërisë midis Krimesë dhe Kosovës është përdorur vazhdimisht nga diplomacia ruse.

Presidenti çek duhet të ketë kaq njohuri sa të dijë se, ashtu si Çekia dhe Sllovakia janë dy shtete të rinj, që lindën nga prishja e Çekosllovakisë, edhe Kosova dhe gjashtë shtete e reja, që dolën nga ish-Jugosllavia, lindën nga prishja e federatës jugosllave. Krimea nuk ishte e pushtuar nga forca ukrainase dhe as po ushtrohej gjenocid e spastrim etnik i popullsisë së saj nga ushtria ukrainase, siç veproi ushtria dhe policia e Serbisë ndaj popullit shqiptar të Kosovës. Dikush duhet t'i thotë presidentit çek se duhet të lexojë më mirë rezolutat e OKB-së dhe t'i bëjë të qartë se pavarësimi i Kosovës nuk iu kundërvu ndonjë rezolute të OKB-së dhe se rezoluta 1244 përmban edhe referendumin për statusin e Kosovës. Dikush duhet t'i thotë presidentit çek se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, si tribunali më i lartë juridik ndërkombëtar, në 22 korrik 2010 e ka vlerësuar aktin e pavarësisë së Kosovës se është në përputhje me ligjin ndërkombëtar dhe si një akt, që nuk bie ndesh me rezolutën 1244. Dikush duhet t'i thotë presidentit çek se Serbia me nënshkrimin e Marrëveshjes së Kumanovës në 9 qershor 1999 është larguar vullnetarisht nga territori i Kosovës, duke ia lënë administrimit dhe proteksionit ndërkombëtar. Dikush duhet t'i thotë presidentit çek se referendumi në Krime në mars të vitit 2014 u organizua pas pushtimit të saj nga forcat ruse dhe ishte një referendum i organizuar nga pushtuesi dhe rezultati as mund të njihet dhe as të quhet "çështje e mbyllur". Dikush duhet t'i kujtojë se në vitin 1991 është organizuar në Krime një referendum demokratik, ku popullsia e Krimesë ka votuar me vullnet të lirë për të qëndruar me Ukrainën dhe jo për t'u bashkuar me Rusinë.

Qëndrime si këto të presidentit çek në Asambledhë Parlamentare të Këshillit të Europës janë zhvillime negative, ku shtetet e tjera të NATO-s si Shqipëria kanë të drejtë t'i shtrojnë vetes pyetjen nëse e meritojnë kryetarë të tillë shtetesh angazhimin dhe detyrimin që Shqipëria të rreshtohet me Çekinë në rastin e një agresioni të mundshëm ndaj saj. Çekia e ka provuar agresionin direkt rus në vitin 1968, por presidenti çek e ka harruar atë agresion. Po të shkohej me logjikën e presidentit çek, Rusia duhet ta mbante të pushtuar Çekinë edhe sot e kësaj dite dhe të ishte mjaftuar me një kompensim financiar ndaj Pragës. Para pak kohësh "EuroObserver" shkruante: "Presidenti çek është kali i Trojës i Rusisë".

Qëndrimi antihistorik i presidentit çek e vendos atë kundër interesave jetike të Republikës Çeke, të cilat janë identike me BE-në dhe me NATO-n, ku Çekia ka aplikuar dhe anëtarësuar me vullnet të lirë. Në një artikull me titull "Fansat e Putinit në BE dhe në NATO", botuar në 29 shtator 2014, kam shkruar: "Flirtet prorus të udhëheqësve të disa shteteve prekin interesat e të gjitha shteteve anëtare të këtyre aleancave dhe organizatave, përfshirë edhe Shqipërinë. Është e kuptueshme se qëndrime si këto të presidentit çek, të kryeministrit sllovak apo të kryeministrit hungarez, e dobësojnë unitetin e NATO-s dhe të BE-së" ("Ballkani faustian", 2016, fq.280).

Vazhdimi i misionit prorus të presidentit çek tregon se presioni i BE-së dhe i NATO-s mbi të dhe mbi Çekinë nuk ka qenë në masën e duhur.

Illir Daja lë pushim titullarët e mesfushës, pasi në mesjavë vjen Partizani i Beogradit

Skënderbeu blindon vendin e parë

Në Korçë, bardhekuqtë thyejnë 4-1 Lushnjën



Jeton Selimi

Skënderbeu shënon poker golash në portën e Lushnjës dhe pret i qetë përballjet e ndjekëse. Korçarët kanë fituar 4-1 ndaj lagunoërve në një ndeshje të dominuar nga të besuarit e Illir Dajës, që kishte lënë në stol disa prej titullarëve të mesfushës në prag të takimit të rëndësishëm të Ligës së Europës me Partizanin e Beogradit. Skënderbeu e nis mirë takimin dhe kontrollon menjëherë territorin, ndërsa në minutën e 13-të Bejte do të thirret në detyrë nga Bruno Dita, me mesfushorin që gjuan fort, por me portierin lagunar që grushton në këndore. Megjithatë bardhekuqtë do ta konkretizojnë shpejt dominimin e tyre me golin e Afrim Takut, që në minutën e 20-të e ka shumë të lehtë të shtyjë topin në rrjetë pas gjuajtjes së



Ali Soue. Por pavarësisht hendekut të madh mes dy ekipeve, Lushnja tregoi se në Korçë nuk kishte shkuar për shëtitje, kur në minutën e 29-të do të finalizojnë një aksion model me Monen që harkon në zonë për Jetmir Sefën dhe me "ujkun" e Lushnjës që në planzhon ndëshkon Shehin. Megjithatë, Skënderbeu e merr veten shpejt nga ky gol dhe në minutën e 33-të Soue fton në gjuajtje Xhejmsin, goditja e të cilit jep iluzionin e golit, por del ngjitur me sh-

tyllën e majtë të Bejtes. Sidoqoftë vendësit do të kthehen në epërsi pa u mbyllur 45 minutat e para, me Takun që shënon golin e dytë të takim-

it dhe të dytin personal në minutën e 41-të. Pjesën e dytë vendësit do ta nisnin në sulm dhe në minutën e 57-të Muza-ka ka të gjitha shanset për të

Shkëlqen gjyqtari Kuka!

Një e veçantë mjaft e këndshme në ndeshjen e së dielës ka qenë dhe gjyqtari Orlando Kuka. Gjyqtari 25-vjeçar arbitron takimin e tij të parë në Kategorinë Superiore pas një eksperience në Itali. Kuka është një nga emrat e rinj që ka afruar FSHF në kuadër të ristrukturimit të kastës së gjyqtarëve dhe në paraqitjen e tij të parë arbitri i ri ka lënë një përshtypje mjaft të mirë!

SUPERLIGA	
JAVA E 6-të	
TË DIELËN	
Skënderbeu - Lushnja	4-1
TË HËNËN	
Kukësi - Teuta	14:00
Laçi - Flamurtari	14:00
Kamza - Vllaznia	14:00
Partizani - Luftëtari	17:00

shënuar, por Bejte reagon në mënyrë të shkëlqyer në gjuajtjen e mesfushorit kryeqytetas. Por goli do të vijë dhe në minutën e 75-të, është Soue, gjuan saktë me kokë pas harkimit të Vangjelit. Në të 79-ën Orges Shehi tregon edhe njëherë se në portë është një djalosh kur ndal gjuajtjen me kokë të Sefës. As 60 sekonda më pas dhe vjen goli çlirues Xhejms, me nigerianin që gjen golin e parë në kampionat dhe në minutën e 80-të vulos shifrat 4-1. Pas kësaj fitoreje, Skënderbeu ngjitet në kuotën e 16-të pikëve, ndërsa Lushnja mbyll tabelën me 2 pikë pas javës së 6-të të superligës.

HABIT TRAJNERI



Juliano: Ndaj Partizanit të

gjithë luajnë fort

Trajneri i Partizanit, Mark Juliano, parashikon një ndeshje mjaft të komplikuar përballë Luftëtari në duelin që dy skuadrat luajnë sot pasdite. Trajneri i të kuqeve ka bërë të ditur se mund të ketë risi në formacionin e skuadrës në krahasim me ndeshjet e mëparshme, me shpresën që kushdo që do të zbrisë në fushë, do të jetë më i qetë pasi është thyer edhe "tabuja" e golit për ekipin e tij. "Jemi në një moment të mirë. Nga fati ndoshta kemi marrë diçka që e meritoni. Në fundin e pjesës së parë ndaj Teutës dhe në pjesën e dytë, kemi arritur të siguronim fitoren. Partizani bëri një ndeshje të mirë dhe e meritoi të merrte këtë fitore të rëndësishme. Tani na pret një ndeshje tjetër po aq e komplikuar dhe e rëndësishme, arrimë aty me më shumë siguri, duke u nisur nga rezultatit që morëm. Do të mundohemi të vëmë në fushë lojtarët që kanë rikuperuar, ata që po rriten dhe ndoshta ndonjë risi. Thuajse të gjitha skuadrat që luajnë kundër nesh janë të uritura, luajnë fort kundër Partizanit. Pavarësisht rezultatit të fundit, Luftëtari ka lojtare shumë të mirë, sidomos në sulm. Por e gjithë skuadra është e mirë, e kemi studiuar, kanë lojtarë krahu shumë të fortë, edhe një mesfushor qendër të mirë, Rroca mos gabohem. Është një skuadër që mund të vërë në veshitë cilindo kundërshtar, po përgatitimi si ta përballim. Kemi pasur pak kohë mes riaftësimit dhe punës efektive në fushë. Por Partizani duhet të bëjë ndeshje agresive, një ndeshje në të cilin do t'u japim stimul lojtarëve të luajnë para".

TRAJNERI I SKËNDERBEUT

Trajneri Illir Daja u shpreh i kënaqur për fitoren e sotme ndaj Lushnjës dhe e vlerësoi maksimalisht kundërshtarin. Në prononcimin pas ndeshjes për "Supersport" Daja foli për problemin e përsimtit të golit në qdo ndeshje dhe për sfidën e së enjtes ndaj Partizanit të Beogradit.

Për sfidën ndaj Lushnjës

Daja: Tani mendojmë vetëm për Partizanin e Beogradit

"Nuk kishim kundërshtar modest, pavarësisht renditjes. E kishim vlerësuar maksimalisht pasi me rivalët tonë kanë bërë paraqitje shumë të mira. Kemi qenë agresivë në zonën e golit. Të shënosh 4 gola ku marrin pjesë edhe sulmuesit na bën të ndihmi mirë."

Pozicioni i ri i Shkodrës
"Mendoj që Donjeti ka disa cilësi, ka bagazh teknik shumë të mirë. E ka rritur

kondicionin, duhet të ketë kërkesa më tepër të paraqitjes në nivel si sot. Kontrollorin para mbrojtjes e bëri shumë mirë."

Pësimi i golit me ekipet e vogla
"Mund të eliminohet pësimi i golit, vepruan gabim krahet e kundër ku lindi aksioni. Lojtarët që u kujdesën për mbylljen e diagonales nuk ishin në pozicionin e duhur. Ka të bëjë edhe pozi-

cioni i ri për Alitin, i cili duhet të tregohet më i kujdesshëm."

Ndeshja ndaj Partizanit të Beogradit
"Neve në qdo ndeshje nuk jemi futur për të marrë një barazim, një gjë të tillë do ta bëjmë edhe me Partizanin e Beogradit. Shkallëzimi duhet të jetë shumë më i mirë se sot. Nuk do i lemë mundësi të na kapin me kundërsulm. Do jemi agresiv si sot.

Do t'i ruhem kundërsulmit."

Gabimi te goli i Lushnjës

"Lojtarët ishin në kohë vonesë, gjë që sollti golin."

Mundësia për më shumë rotacion

"Ne si objektivi kryesor kemi kampionatin. Secila ndeshje ka tri pikë. Bëmë rotacion aq sa mundëhim. Ishim të kushtëzuar edhe nga dëmtimet. U munduam të mos humbnim ekuilibrin e lojës."

Mediat vlerësojnë portierin

"Fox sports": Strakosha kërcënon vendin e Berishës te Shqipëria



Sezonin e kaluar ndoshta u gjend në portë rastësisht. Vinte pas paraqitjes pozitive me Salernitanën, ku kishte luajtur 11 ndeshje në Serinë B. Një dëmtim në pulpë gjatë nxemjes për Marketin bëri që Strakosha të luante titullar në Milano ndaj Milan-

it. Inzagi, në fakt, u mendua, pasi portier i dytë ishte Vargji. Në atë moment, ndoshta për intuitë, zgjodhi Strakoshën. Pak e kuptuan, por ai bëri mirë, astu si dhe i riu shqiptar, që tani vlen shumë e shumë".

SERIE A


Ajeti barazon në shtëpi, Berisha pëson tre ndaj Sampdorias

U mbyllën edhe sfidat e së dielës në Serinë A. Në javën e 8-të, Arlind Ajeti ishte dy herë në avantazh me Krotonen, por u barazua po dy herë nga Torino, në sfidën që u mbyll me shifrat 2-2. Ajeti u ndëshkua edhe me karton të verdhë këtë sfidë. Atalanta e Etrit Berishës ishte në avantazh pas 21 minutave lojë, por më pas në pjesën e dytë, shifrat u përmbysnë në 3-1, me gardianin kuq e zi që nuk i mbeti gjë tjetër vetëm ta nxirrte topin tri herë nga porta e tij. Në ndeshjet e tjera, Xhenoi fitoi 2-3 në transfertën e Kaljarit, ndërsa Bolonja fitoi 2-1 ndaj Spal. Sasuolo dhe Kievo u ndanë në një barazim pa gola, ndërsa më herët në orën 12:30, Fiorentina fitoi përballë Udinës, 2-1. E gjithë vëmendja e kësaj jave përqendrohet në derbin e Milanos, ku Interi dhe Milani prettojnë për një ndeshje spektakolare.



"Fox sports" i ka kushuar një artikull të veçantë portierit të Lacios dhe Kombëtares së Shqipërisë, Tomas Strakoshës, duke treguar përmirësimin e tij të dukshëm dhe duke theksuar faktin se trajneri Inzagi bëri shumë mirë që ia ka besuar portën e tij. Në artikull thuhet se tashmë portieri i ri shqiptar është i madh dhe se shkëlqen në shumë se Dibala i Juventusit. Ja çfarë shkruan konkretisht "Fox sports": "Përfundimisht dhe zyrtarisht i madh, Tomas Strakosha është tashmë një pikë kyçe e Lacios dhe nuk mund të ishte ndryshe. Një vit më parë ishte portieri i tretë, pas Marketit dhe Vargji. Vite më parë ishte numri 24, por tani është numri 1.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

2. Gjëja e latinëve.
5. Ai i Kuq u hap për hebrejtë.
9. Eshhtë fjala e për e foshnjës.
11. Ministri Ekonomisë e Pune
13. Marubi i fotografisë.
14. Bel i Mapupassant.
15. Bëhet duke tregtuar objekte të shenja.
18. Derek aktore.
19. Gjysmë totale.
20. Eshhtë art i të folurit
22. Një patriark bibliq.
24. Mund të jenë zemërkau të tilla.
26. Janë dëshmorë të kishës.
28. Eshhtë lloj papagalli.
29. Eshhtë lloj papagalli.
30. Qerre pa qe.
32. Ekstremer në numërim.
33. Eshhtë bodrumi.
34. Steiger aktor.

10. Eshhtë ai që gënjën për t'u bërë i njohur.
11. Një markë celulari.
12. Ushtrohej nga filibusteriet.
16. Një përsiatje.
17. Agjenci Informative Tiranë.
21. Një bregjtës pylli.
23. Një Gjon që qe aktor i yni.
25. Titulli i Byron.
27. Në radhë të parë.
31. Emri i Amundsen.
36. Moore aktore.
39. Pishtarë pa pishë.
41. Gjysmë vatani.
43. Rruga e Molnar.
45. Një fazë gjumi.
47. Inicialet e Redford.
48. Në krye të notarëve.
49. Inicialet e Reitman.
51. Unë dhe ti.

VERTIKAL

1. Novarro që qe aktor.
3. Kusturica regjisor.
4. Eshhtë e jashtëzakonshme.
6. Inicialet e Kazan.
7. Ishte qyteti i 100 portave.
8. Pinci i Dy herë mat.
9. Janë të mirat që prodhohen.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Nuk kalohet nga mbetësi.
5. U printe gladiatorëve
12. Bëhet duke shkuar lart e më lart
14. Tatum që qe pianist.
15. Një që lufton për para
16. Mund të bëhet me safari
17. Breshkat luftarake të kartonave
19. Ngjitet kur nuk nget
20. Në mes të rrugës
21. Sporti me rikisha
25. U shkrua nga Hesiodi
26. Një sferë për model
27. Mbyllin një sirtar
28. Makina Tipo
30. Inicialet e Bean, aktor
31. Nino, kompozitori i famshëm italian
33. Ramiro pa zë.
34. Neill i Jurassic park.

VERTIKAL


35. E bukura e belle epoqe.
37. Qe mbreti i elfëve
39. Farrow, aktore
40. Hagen rockstar
41. Walter i Kush do ta vrasë Charley Verrik
45. Në fund majtas
46. Mund të preken nga morbusi i Basedow
47. Ad... për të ngarkuarin me punë
48. Loach regjisor
10. Në krye të kryesisë
11. Ughi violinist
13. Carlos që qe pilot i Formula 1
15. Ekstremer në muzg
18. Inicialet e Steinbeck
22. Gruda, "Njeriu me top"
23. Eshhtë X ajo e sulmit
24. Paradhoma e parajasës
28. Eshhtë edhe ai i luftës
29. Janë edhe ato të cirkut
31. Mbarojnë fare
32. Inicialet e Reed, aktor
34. Të parët në sondazh
36. Eshhtë taksa
38. Një mund të jetë emërora
39. Një pjesë e marrëzisë
41. Gjysmë mimoze
42. Hundë kur s'jam unë
43. Skuadër greke
44. Lemper, këngëtare gjermane
46. Fundi i një akti



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

5	2			9			3	4
6		4				8		1
		9	1		8	3		
8								5
		2	5		9	6		
9		5			4			7
2	1			3		6	9	

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	4	1	3	5	8	2	9	6
9	2	8	4	1	6	3	7	5
3	5	6	9	7	2	8	4	1
5	6	4	1	2	9	7	8	3
2	3	9	7	8	5	6	1	4
1	8	7	6	3	4	9	5	2
8	1	3	2	4	7	5	6	9
4	9	5	8	6	3	1	2	7
6	7	2	5	9	1	4	3	8



Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Mposht njëmijë herë, njëmijë burra në betejë: vetëm ai që mund veten është luftëtari më i madh.
- Asgjë nuk është konstante, përveç ndryshimit.
- Nuk ka zjarr të barabartë me pasionin, ose peshkëqen me urrejtjen, as kurth me çmendurinë, ose përura me lakminë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FERMANI T J NA
AKSIOVALE
ROKNEPFRENATI
AHIPOKRITETED
DEMOSTENITKE
DIKASTERETNOR
AMALIAIZENEAE
DELERAE O E
ARIT EPIETEET
IOMADIMADHI
SRITIELEHIN
TERRORIRENATI

FJALËKRYQI (2)

LULIS SPAMALIA
ALKITROBERIA
PFERIODIKENNA
FINALJAJAARNA
REPARETENSIA
TEREK SIPNIN
PAREITTRUKETI
ARITREALEKUPA
SANDENIRETE
TANDEMLETRAU
JUHOKATEARMA



Thënie të mençura

- Sokrati: Lumturia është dhunti e natyrshme, mjerimin e shkaktajnë mungesat artificiale.
- Të pamposhturit janë ata që tregohen të fortë, kur sulmohen në pikat e dobëta.
- Mos akuzo njerëzit për zhgënjimet e tua, akuzo vetveten që ke pritur shumë nga njerëz që s'duhej të prisje asgjë.
- Kur ti të fitosh, unë me krenari do i them botës: "Ky është miku im". Por kur të humbasësh, unë do të jem pranë teje, duke të shtrënguar dorën dhe të të them: "Unë jam miku yt."

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

